

**BOTA<sup>e</sup>**

**SIGAL**   
UNIGA GROUP AUSTRIA

BOTIM SPECIAL  
22 SHKURT **2022**

**jetojmë më mirë  
së bashku**



## Një vit për tu mbajtur mend!!

Blije siguracionin  
**15%-23%**  
 më lirë

Nxtoni!  
 Oferta është e vlefshme  
 deri në 19 mars 2022

sigal.com.al



## Jetojmë më mirë së bashku

Ndryshimi fillon brenda nesh

Ne e konsiderojmë vetveten si një komunitet për një jetë më të mirë. Çdo ditë, ne mbështesim njëri-tjetrin dhe klientët tanë për të marrë vendime të cilat përmirësojnë në mënyrë të qëndrueshme jetën e tyre. Duke vepruar kështu, ne mendojmë për të ardhmen tonë – çfarë ndryshimesh na nevojiten sot në mënyrë që ne të mund të jetojmë më mirë së bashku duke filluar nesër? Edhe nëse diçka e tillë do të thotë se disa gjëra duhet të ndryshojnë, ne kërkojmë që të udhëheqim rrugën si pionerë dhe të frymëzojmë të tjerët. Vetëm nëse ne ndysojmë vetveten, nëse ne jemi të guximshëm dhe i monitorojmë gjërat aktivisht, vetëm kështu ne mund të bëhemi më të mirë.

Ne jemi më shumë sesa një kompani sigurimi

Ti, unë, ne. Secili prej nesh ka historinë e tij/saj. Por ajo që na bashkon ne të gjithëve në UNIQA është: Ne kërkojmë që të kujdesemi për njerëzit – dhe ne e bëjmë këtë më mirë se sa kushdo tjetër. Së bashku, ne i shërbejmë 15 milionë njerëzve në 18 vende me një objektiv të qartë për ta bërë jetën më të mirë për klientët tanë dhe për ata që janë më afër tyre. Ne jemi më shumë sesa një kompani sigurimi. Me ofertat novatore dhe shërbimin cilësorë, ne vazhdojmë më tej, me përgjegjësi zhvillimin e vetvetes, të shoqërisë dhe të mjedisit tonë. Ne jemi një partner i besueshëm drejt rrugës për një jetë më të mirë – nëpër të gjitha stuhitë e ndryshimit, krahë për krahë. Sepse ne jemi të bindur se: Se bashku ne jetojmë më mirë.

Ne ndrysojmë vetveten dhe rrjedhimisht edhe botën gjithashtu

Nëse kërkon që të formësoni të ardhmen tuaj dhe të përmirësoni jetën tuaj dhe botën tuaj, zgjidhni UNIQA. Sepse ne jemi komuniteti për një jetë më të mirë. Për ju, për të dashurit tuaj dhe për botën tonë. Ne ju mbështesim ditë pas dite në të gjitha situatat e jetëve tuaja për të marrë vendimet që ju përshtaten më mirë dhe që përmirësojnë jetën tuaj. Që prej vitit 1811, ne jemi ngritur mbi fuqinë e një komuniteti të përbërë prej miliona njerëzish të cilët sigurojnë njëri-tjetrin. Dhe ne jemi të angazhuar ndaj kësaj. Sot dhe për të ardhmen.

## Përmbajtja

HYRJA - "JETOJMË MË MIRË SË BASHKU"

CEO UNIQA Insurance Group / A. Brandstetter: Si ishte viti 2021 dhe pritshmëritë për vitin 2022 për CEO-n e UNIQA Insurance Group

CEO SIGAL UNIQA / A.Ponari: Sfidat që nuk na ndalën dhe çelësi i suksesit

23 VJET SIGAL - HISTORIKU 1999-2022

Siguro Jetën me SIGAL, qëndro gjithmonë një hap përpara

Pensionet Private, alternativa më e mirë për të ardhmen

SIGAL UNIQA, infrastrukturë e duhur organizative duke respektuar legjislacionin në fuqi

23 vite me SIGAL, rruga e suksesit drejt një bashkëpunimi virtuoz

Aftësia paguese dhe stabiliteti financiar i SIGAL UNIQA Group Austria

Aktuaristika, ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatet dhe qëndrueshmërinë financiare që SIGAL UNIQA gëzon sot

Marrëdhëniet pozitive me UNIQA Insurance Group, jetike për zhvillimin e SIGAL

SIGAL UNIQA promotore e produkteve të siguracionit të pasurisë

Në celularin e çdo shqiptari me Teleshëndet

SIGAL Uniqa kompani lider në sigurimin e mjeteve

SIGAL UNIQA e vetmja kompani sigurimi në Shqipëri që ofron të gjitha produktet e Marinës

Blerje Online dhe transformimi rrënjësor i industrisë tradicionale të sigurimeve

Viti 2021, një tjetër vit sukcesi/ Asnjë kompani nuk ka paguar sa SIGAL UNIQA

Korrektësia ndaj klientëve dhe pagimi i dëmeve në kohë, çelësi i suksesit për SIGAL UNIQA Group Austria

"Kartoni Jeshil", SIGAL UNIQA ju mbron edhe kur udhëtoni jashtë Shqipërisë

SIGAL UNIQA Group Austria "rrëmben" tregun e Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut

Klinika Lëvizëse "SIGAL UNIQA", 5.849 vizita dhe 4.525 km të përshkruara prej 2015-ës

Të humbur në tingujt magjik të Orkestrës së Harqeve SIGAL UNIQA...

SIGAL UNIQA, partnere e përhershme e Sportit

2021 viti i suksesit të padiskutuar të UNIQA Insurance Group

SË BASHKU NË ÇDO SFIDË

Ekipet SIGAL UNIQA Group Austria

Kontaktet e degeve SIGAL UNIQA Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut

## Si ishte viti 2021 dhe pritshmëritë për vitin 2022 për CEO-n e UNIQA Insurance Group

ANDREAS BRANDSTETTER  
CEO, UNIQA Insurance Group



CEO i UNIQA Insurance Group, Andreas Brandstetter në një intervistë për Gazetën Raiffeisen ka folur rreth ristrukturimit të grupit të sigurimeve UNIQA në Evropën Qëndrore dhe Lindore, efektet e pandemisë COVID-19 dhe planet për të ardhmen e kompanisë që ai drejton.

Korona ka dominuar gjithashtu veprimet gjatë vitit 2021. Cila është përmbledhja juaj për vitin e dytë të pandemisë?

Andreas Brandstetter: Nga pikëpamja ekonomike, ne e kemi kapërcyer pandeminë shumë më mirë sesa ishim drujtur në fillim, veçanërisht viti 2021 shënoi një rikurperim të fuqishëm. Pasoja ekonomike pozitive dhe negative të pandemisë pak a shumë janë ekuilibruar në UNIQA, me rezultate më të larta, veçanërisht në fillim të pandemisë, për shembull për shkak të ndërprerjeve të biznesit, ku janë shënuar rënie për shkak të rënies së sektorit motorik. Nga kjo krizë shëndetësore, mësimi kryesor që ne morëm – është veçanërisht e rëndësishme që të jemi afër klientëve, njëherësh fizikisht dhe dixhitalisht.

UNIQA është siguruesi i shëndetit më i madh në Austri. Cilat janë pasojat afatgjata të pandemisë?

Andreas Brandstetter: COVID do të jetë i paranishëm në industrinë evropiane të sigurimeve për një

kohë shumë të gjatë. Për më tepër, ne monitorojmë gjithashtu efektet kryesore tek shëndeti mendor, të cilat po bëhen gjithnjë edhe më të rëndësishme dita ditës. Kjo është arsyeja përse vitin e kaluar ne blemë Consentiv, ofruem më të madh privat në Austri për kujdesin e shëndetit mendor profesional. Prej marsit të vitit të kaluar, ne po ofrojmë kontrolle pas-COVID me shpenzimet tona për klientët e shëruar të UNIQA për të vlerësuar më mirë pasojat e mundshme të sëmundjes. Ky shërbim është mirëpritur shumë mirë, dhe ne e kemi zgjatur deri në qershor të vitit 2022. Kjo është arsyeja përse ne ofrojmë njësi psikoterapie dixhitale me ekipin e terapisë online të pas-COVID, të cilat synojnë të ndihmojnë klientët e prekur me trajnime të moderuara për të ardhur sërish në formë pas sëmundjes COVID-19.

Çfarë ishte e kënaqshme për ju gjatë 2021?

Andreas Brandstetter: Niveli i lartë të punës së punonjësve tanë. Presioni fizik mbi ekipet tona ka qenë shumë i lartë në vitin e parë të transformimit tonë strategjik. Për më tepër, ne jemi të kënaqur me integrimin e qetë të kompanive që blemë nga AXA në Poloni, Republikën Çeke dhe Sllovaki, e cila deri tani ka ecur në mënyrë të shkëlqyer.

Në fillim të dhjetorit 2021, UNIQA grumbulloi 375 milionë euro nëpërmjet bonove të gjelbra. Sa larg keni arritur përse i takon investimeve të gjelbra?

Andreas Brandstetter: Ne jemi në mes të pikës së kthesës. Siguruesit e Evropës kanë më shumë sesa 10 trilionë euro asete nën menaxhim, duke i kthyer ata në investitorin institucional më të madh në BE. Tashmë UNIQA ka investuar rreth një miliardë euro në asete të gjelbra dhe ne vazhdimisht hedhim hapa për të njësuar më tej portofolin tonë drejt qëndrueshmërisë.

Cilat janë ndjesitë tuaja për vitin 2022?

Andreas Brandstetter: Mjedisi makroekonomik duket sikur po vështirësohet. Ne nuk kemi ende një busull, mbi se çfarë do të sjellë Korona dhe mutacioni i ri Omikron. Unë pres që tremujori i parë i jetës publike të jetë i ngarkuar. Varet nga politika nëse do të jenë të nevojshme reformat në fushat e rëndësishme të pensioneve, kujdesit, tregjeve kapitale dhe arsimit. Por ekonomia austriake në mënyrë të përsëritur ka gjendur zgjidhje të mira në situata të vështira, veçanërisht tani që politika është e dobët. Ne kemi sipërmarrje të vogla dhe te mesme (SME) të shëndetshme, një etikë të lartë pune dhe kompani novatore, kështu që unë jam optimist për vitin 2022.

## 23 vite SIGAL UNIQA Sfidat që nuk na ndalën dhe çelësi i suksesit

AVNI PONARI  
CEO, SIGAL UNIQA Group Austria



Kur e nisëm rrugëtimin, bashkë me bashkëudhëtarët e mi të fillimit, që vazhdojmë të jemi edhe sot së bashku, nuk ishte e lehtë. Kjo për shkak të mungesës së eksperiencës së sigurimeve në Shqipëri, mungesës së infrastrukturës, kapitalit, bazës ligjore dhe shumë eksponentëve të tjerë.

23 vite më parë, kur Shqipëria vinte nga një vend komunist dhe kalonte në një ekonomi tregu të hapur pa patur një model për tu ndjekur, pa patur ekspertizë dhe mbështetje europiane siç e kemi sot, pa patur një kulturë sigurimesh në popullsi, duhet konsideruar si një guxim shumë i madh të ndërtoje një kompani sigurimesh private.

Unë së bashku me katër bashkëpunëtorët e mi, të cilët i kisha patur kolegë më herët në kompaninë shtetërore, arrita ti bind që ti bashkohen idesë time, dhe së bashku ndërtoam të parën kompani private të sigurimeve në Shqipëri, e cila rezultoi të ishte një sukses falë punës dhe përkushtimit të të gjithëve ne, por edhe të qindra punonjësve dhe bashkëpunëtorëve të tjerë që na u bashkuan rrugës.

Kur e nisi punën SIGAL ishte në disavantazh me kompaninë e vetme shtetërore të asaj kohe, sepse SIGAL e nisi punën në një zyrë të vogël në Bulevardin Zogu I, me vetëm 5 persona dhe një kapital prej 400 mijë dollarësh.

Përballë kishte një kompani shtetërore me 1500 punonjës të gjithë me disa vite eksperiencë dhe me një kapital dhjetëra herë më të madh sesa ne. Por kjo nuk na dekurajoi ne. Përkundrazi, ishte një motiv më tepër për të punuar fort dhe për të arritur objektivat tonë.

23 vjet më parë ishte shumë e vështirë jo vetëm të futeshe në treg, por ta ndërtoje tregun, sepse deri në ato momente ekzistonin vetëm sigurimet e makinave, të marinës dhe aviacionit dhe asgjë tjetër. Ndaj, na është dashur që të ndërtojmë një treg sigurimesh të diversifikuar, të krijojmë ekspertizën, bazën ligjore, të krijojmë produkte të reja duke iu përshtatur nevojave dhe buxhetit të klientëve.

Nëse do të kishte një meritë të veçantë që mund ti jepnim sot SIGAL, krahas ndërtimit të një ekspertize dhe përvoje të tregut në tërësi, është që futi të parin investitor të huaj dhe

strategjik në Shqipëri, fillimisht Fondin Shqiptaro - Amerikan të Investimeve dhe më pas UNIQA Group Austria. Këto dy momente shënuan një kthesë të madhe jo vetëm në historinë e SIGAL, por në të gjithë tregun shqiptar të sigurimeve. Kjo solli një standartizim të tregut në Shqipëri dhe një përmirësim e rritje të shërbimit ndaj klientëve, duke u ofruar atyre produkte dhe shërbime me standarte europiane.

Çelësi i suksesit në këto 23 vite?

Pagesën në kohë të dëmeve dhe shërbimin me korrektësi ndaj klientëve. Çdo klient është i rëndësishëm për SIGAL UNIQA-n.

Kjo gjë na ka bërë që në mbi 2 dekada të jemi liderë në tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe jo vetëm dhe duke fituar një sërë çmimesh ndërkombëtare.

Nuk mund të le pa falenderuar edhe miliona klientë që gjatë këtyre 23 viteve na kanë besuar shëndetin, shtëpinë, biznesin, automjetin e pasuri të tjera.

FALEMINDERIT

**22 SHKURT 1999  
THEMELIMI I SIGAL**

Pas 2 vitesh rrahje mendimesh dhe diskutimesh dhe pas një pune të lodhshme me bashkëpunëtorët e tij, Avni Ponari ja doli që në ato kohë të vështira për Shqipërinë, të themelonte në 22 shkurt 1999 kompaninë e sigurimeve SIGAL.

**2003**

Viti 2003 ka një rëndësi të veçantë për SIGAL, sepse arrin të tërheqë të parin investitor të huaj të investonte në tregun e sigurimeve vendas.

Departamenti i Shtetit Amerikan nëpërmjet Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve, investoi tek SIGAL, duke blerë 13.3% të aksioneve.

Në të njëjtin vit, më 23 tetor, SIGAL përfundon të gjitha marrëveshjet dhe realizon blerjen e kompanisë së sigurimeve Drini në Kosovë, duke themeluar kështu SIGAL Jo-Jetë në Kosovë dhe më pas zgjerohet edhe me kompaninë Sigal Jetë.

Dy kompanitë e sigurimeve, SIGAL Shqipëri dhe SIGAL Kosovë krijuan një marrëveshje dhe mundësuan lëvizjen e lirë të automjeteve midis Shqipërisë dhe Kosovës. Pra mjetet e Kosovës hynin në Shqipëri dhe ato të Shqipërisë hynin në Kosovë pa paguar asgjë. Sigurimi i Shëndetit dhe Aksidenteve ishte

prioritet i produkteve për vitin 2003 dhe SIGAL ka meritën e të qenurit e para kompani sigurimesh në Shqipëri, e cila u ofroi klientëve produktet e sigurimit të shëndetit.

**2004 - 2006  
"SHTËPI E RE"  
dhe "SIGAL  
Risigurime"**

Më 22 shkurt 2004 SIGAL mbushi 5 vjeç. 5-vjetori e gjeti kompaninë me "shtëpi" të re. Drejtoria e Përgjithshme e SIGAL u transferua në zyrat e reja në hyrje të bulevardit "Zogu I", sot godina e "SIGAL Business Center", ndërsa

zyrat e fillimit u zgjeruan dhe u shndërruan në Degën e SIGAL për Tiranën.

Në të njëjtin vit SIGAL, ishte e para dhe e vetmja kompani, e cila fitoi të drejtën e ofrimit për klientët të të gjitha klasave të sigurimit.

Në vitin 2004, SIGAL zgjerohet dhe shtrin aktivitetin edhe në Maqedoni, ndërsa në Shqipëri, dy vite më vonë, krijon një tjetër kompani, atë të sigurimeve të Jetës si dhe hap të parën dhe të vetmen kompani Risigurimi në Shqipëri. "SIGAL Risigurime" vazhdon të mbetet e para dhe e vetmja kompani risigurimi në Shqipëri, që prej themelimit të saj në vitin 2006.

**2007 – PJESË E UNIQA GROUP AUSTRIA**

Viti 2007 pati një sërë zhvillimesh të rëndësishme për SIGAL. Në muajin mars, SIGAL bëhet pjesë e një prej grupeve financiare më të rëndësishme në Europën Qendrore-Lindore, UNIQA Group Austria.

UNIQA, me shtrirje në atë kohë në 13 shtete europiane, dhe kompani me histori mbi 200-vjeçare në tregun e sigurimeve të Europës, kishte shprehur interes që të hynte në tregun e Shqipërisë dhe Kosovës dhe të investonte në këto tregje.

Nga studimi që drejtuesit e UNIQA-s i kishin bërë tregut në Shqipëri, konkluduan që SIGAL ishte e vetmja kompani që përmbushte të gjitha kriteret e menaxhimit, stafit, asetëve, strategjisë, lidershit dhe çdo elementi që kërkonin tek një kompani për tu bërë partnerë

biznesi. SIGAL, u riemëruar SIGAL UNIQA Group Austria, dhe nuk mbarti vetëm emrin e grupit të fuqishëm financiar të tregut të sigurimeve në Europë, UNIQA, por mori të gjithë eksperiencën 100-vjeçare të saj dhe standartet europiane të punës, menaxhimit dhe shërbimit ndaj klientëve.

Viti 2007 shënoi një tjetër sukses për SIGAL, sepse themeloi të parin Fond Pensionesh Private në Shqipëri, një risi kjo në tregun e sigurimeve, ku qytetarët, tanimë më si në çdo vend tjetër të Europës apo botës, mund të kontribuonin për veten e tyre dhe të kishin një pension privat të denjë për moshën e pleqërisë.



**VITI 2009 - 10 VJET SIGAL**

Viti 2009 ishte vit jubilar për SIGAL UNIQA-n sepse festonte plot 10 vjet nga themelimi. Me këtë rast u zhvillua një mbrëmje gala në Pallatin e Operas dhe Baletit me interpretimin e sopranos së mirënjohur Inva Mula. Me qindra të ftuar, personalitete të fushave të ndryshme, staf dhe partnerë të SIGAL ishin prezentë në mbrëmje, ndërsa për publikun u transmetua nga televizionet më të mëdha shqiptare.

Një ngjarje e rëndësishme e këtij viti është përforcimi i bashkëpunimit me aksionerin UNIQA, e cila bleu aksione të tjera të SIGAL dhe arriti totalin

68.64%. Ndërsa në Maqedoni SIGAL u ribrendua në UNIQA a.d, më 14 nëntor 2009.

**VITI 2011 – ZGJERIM RAJONAL DHE LICENSIMI I FONDIT TË PENSIONEVE**

SIGAL UNIQA vazhdon rritjen dhe zgjerimin e aktivitetin në tregun shqiptar të sigurimeve si dhe në atë rajonal. Në vitin 2011, SIGAL UNIQA zgjerohet me kompani të reja, duke themeluar në Kosovë SIGAL Life Uniqa si dhe në Maqedoni UNIQA Life Shkup për sigurimet e jetës.

Ndërkohë, Fondi i Pensioneve SIGAL, i themeluar në vitin 2007, licensohet nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare për të

zhvilluar aktivitetin konform legjislacionit në fuqi. Me themelimin e kompanive të reja, grupi SIGAL Uniqa në vitin 2011 numëronte 8 kompani kompani sigurimesh jetë, jo-jetë, pensione dhe risigurime. Këtë vit SIGAL UNIQA vlerësohet nga Business International Alternative me çmimin “International Gold Star for Quality”, ç’ka përforconte edhe më tepër cilësinë e shërbimit dhe standartet e larta të produkteve që SIGAL UNIQA ofronte klientëve të saj.

**VITI 2012 - ARMËT E SKËNDERBEUT NË TIRANË**

Viti 2012 ishte vit jubile i të gjithë shqiptarëve, sepse përkonte me 100-Vjetorin e Pvarësisë së Shqipërisë. Me këtë rast, SIGAL UNIQA u dhuroi shqiptarëve atë që të gjithë e ëndërronin prej shumë vitesh: Armët e Skënderbeut në Muzen e Tiranës, të hapura për tu shikuar nga të gjithë. Idea fillestare u hodh nga Andreas Brandstetter, CEO i UNIQA Group, gjatë një

mbledhje bordi me SIGAL në Tiranë. Idea që u përfaqua nga Drejtuesi i Bordit të Fondit Shqiptaro-American të Ndërmarrjeve, Michael Granoff, një dashamirës i Shqipërisë, u bë motiv për themeluesin dhe drejtuesin e SIGAL UNIQA, Avni Ponari, i cili punoi fort dhe bëri që ëndrra e të gjithë shqiptarëve të bëhej realitet. Kjo ishte hera e parë dhe e vetmja deri më tani që armët e Heroit tonë Kombëtar erdhën në Shqipëri. Me këtë rast, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Z. Bujar Nishani, dekoroi CEO-m e UNIQA Group Austria, Z. Andreas Brandstetter, me “Medaljen e Mirënjohjes”, për mbështetjen e jashtëzakonshme që UNIQA, dhe në veçanti vetë


Brandstetter, në bashkëpunim me SIGAL-in dhanë për ardhjen e armëve të Skënderbut në Muzeun Kombëtar në Tiranë.

**VITI 2017 – 10 VJET SIGAL & UNIQA**

SIGAL dhe UNIQA shënuan 10 vite bashkëpunim, që nga koha e blerjes së aksioneve të SIGAL nga UNIQA Group Austria për herë të parë në vitin 2007. Me këtë rast u zhvillua një aktivitet dhe një konferencë për mediat në ambientet e Hotel Sheraton në Tiranë. Në këte ceremoni të veçantë morën pjesë CEO i UNIQA International, Z. Wolfgang KINDL, CEO i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA për Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë Z. Avni PONARI, Ambasadori i

Austrisë në Shqipëri, SH. T. Z. Johann Sattler si dhe personalitete të larta të biznesit, ekonomisë dhe financave në Shqipëri.

SIGAL gëzon meritën për futjen e të parit investitor strategjik në tregun shqiptar të sigurimeve, i cili pati një ndikim të madh në standartizimin e tregut dhe në përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve ndaj klientëve. Në 10-vjetorin e bashkëpunimit me UNIQA-n, SIGAL hapi për herë të parë dyert e një muzeu krejtësisht të veçantë. “Muzeu i Sigurimeve SIGAL UNIQA”, i pari në llojin e tij në të gjithë rajonin, i pozicionuar në zyrat qendrore të kompanisë, muzeu paraqet historikun e SIGAL që nga themelimi në vitin 1999 e në vazhdim.



**VITI 2019 - SIGAL UNIQA Group Austria 20 VJEC**

Me rastin e 20-vjetorit SIGAL UNIQA ideoi dhe realizoi një vepër, skulpturë, në shenjë falënderimi dhe mirënjohjeje për klientët, stafin, partnerët dhe të gjithë bashkëudhëtarët e SIGAL UNIQA ndër vite. Veprametëm, "MIRËNJOHJE-FALENDERIME PËR TË GJITHË", u vendos në qendër të Tiranës, në rrugën "Urani Pano", shumë pranë zyrave të Drejtorisë së Përgjithshme të SIGAL UNIQA.

2020 - SIGAL UNIQA, kompania që kontribuon në çdo sfidë Me dorën në zemër dhe dëshirën e mirë për të kontribuar sadopak për familjet shqiptare që u prekën nga tërmetet e fundvitit 2019, SIGAL UNIQA dhuroi 60 mijë euro, një shumë

sa simbolike por aq edhe domethënëse, që na tregon të gjithëve se duke kontribuar të gjithë nga pak, në fund bëhet shumë.

**2022 – 23 VJET SIGAL / 15 VJET SIGAL – UNIQA**

Ky 23-vjetor na gjen sërish si kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon me mbi 80 milionë euro prime vjetore dhe mbi 34 milionë euro dëme të paguara. Numërojmë 2053 punonjës dhe agjentë dhe mbi 1100 zyra në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Ndërkohë, në mars mbushen plot 15 vite nga nisja e bashkëpunimit me SIGAL dhe gjigandit europian të sigurimeve UNIQA Insurance Group.

Në vitin 2007 UNIQA vendosi të blejë pjesën më të madhe të aksioneve të SIGAL SH.A, duke u kthyer kështu në një partner kyç për kompaninë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, por edhe një faktor i rëndësishëm për tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon.

Futja e UNIQA-s ka qenë jo vetëm një garanci për tregun shqiptar, por edhe një indikator që ka luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen dhe përmirësimin e tregut të sigurimeve në rajon, sikundër ka ndikuar jo pak edhe në ekonominë shqiptare.



**SIGAL UNIQA Group Austria**

Themeluar më 22 shkurt 1999

Grup rajonal me 8 kompani sigurimi, risigurimi dhe Fond Pensioni Vullnetar

Operojmë në 3 shtete: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut

Që prej vitit 2002 udhëheqim tregun shqiptar me rreth 30%

reth € 80 milionë Prime/vit

€ 121.2 milionë Asete

€ 400 milionë dëme të paguara ndër vite

1,000,000 klientë

2 000 punonjës dhe agjentë

Mbi 1 100 zyra në 3 shtete

Të parët në blerjen online të siguracioneve

E vetmja kompani që ofron të gjitha klasat e sigurimit



2019

20 vjet histori Skulptura "Mirënjohje – Falenderime për të gjithë" vendoset në qendër të Tiranës, pranë zyrave qendrore të SIGAL UNIQA CEO i SIGAL UNIQA, z.Avni Ponari nderohet nga presidenti i Austrisë me dekoratën e lartë "Grand Decoration of Honour"



2020

Z.Avni Ponari vlerësohet nga Perandori i Japonisë me titullin "The Order of the Rising Sun, Gold rays with Neck Ribbon" për kontributet e tij të jashtëzakonshme për promovimin e shkëmbimeve dhe përforcimin e marrëdhënieve miqësore Shqipëri-Japoni.



2021

10 - VJETORI I FONDIT TË PENSIONEVE SIGAL Pjesë e SIGAL UNIQA Group Austria, Fondi SIGAL është fondi më i madh i pensioneve private në Shqipëri duke zotëruar 44% të tregut.




2022

23 vjet SIGAL UNIQA kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon. Në mars mbushen plot 15 vite nga nisja e bashkëpunimit me SIGAL dhe gjigandit europian të sigurimeve UNIQA Insurance Group.



# KOMPANIA MË E MADHE DHE MË E BESUAR E SIGURIMEVE NË SHQIPËRI, KOSOVË DHE MAQEDONI E VERIUT.



**Edvin Hoxhaj**  
Administrator i  
Përgjithshëm i SIGAL Life  
UNIQA Group Austria

“ Misioni i shoqërive të sigurimit të jetës në SIGAL UNIQA është ofrimi i sigurisë financiare. Si pjesë e SIGAL UNIQA, sigurimet e Jetës plotësojnë gamën e shërbimeve që grupi ofron në këto vende, si produkte të veçanta në platforma të përbashkëta, por edhe si bashkësigurime. Me mbi 9 milionë euro të ardhura vjetore nga primet, sigurimet e Jetës kontribuojnë me 14% në veprimtarinë e SIGAL UNIQA,

## Siguro Jetën me SIGAL, qëndro gjithmonë një hap përpara

Të qenurit i shëndetshëm është pasuria më e çmuar për çdo individ dhe diçka e tillë nuk është lehtësisht e mohueshme. Kjo vjen si rrjedhojë e faktit që të gjithë jemi të ekspozuar mjaft në jetën e përditshme ndaj sëmundjeve apo aksidenteve të tjera të shumëllojshme, të cilat kërcënojnë seriozisht jetën tonë. SIGAL UNIQA Group Austria mbetet kompania lider në tregun shqiptar dhe jo vetëm, edhe në fushën e sigurimeve të Jetës, duke i dhënë klientit një shërbim mjaft profesional dhe që përmbush nevojat e tij në rastet e sipërpërmendura. Në vija të përgjithshme, sigurimi i jetës duket si diçka jo urgjente për t'u përdorur, por e mira është që pas informimit të nevojshëm do të kuptoni se është pikërisht ky investim për veten një kursim që kryhet tani për të pasur një të ardhme të sigurtë. Duke qenë se në SIGAL UNIQA Group Austria, besueshmëria e klientit është një ndër anekset më të rëndësishme, përgjegjësia e shoqërisë ndaj këtyre ndërmjetësimeve është më e madhe, madje konsiderohet si një marrëveshje privilegjuese. Vitin e fundit, bazuar edhe në raportet e publikuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), sigurimet e jetës kanë pësuar një rritje kolosale, ku primi bruto arrin deri në 19.3 miliardë lekë ose pothuajse në 160 milionë euro. Për këtë ka ndikuar sigurisht

edhe pandemia Covid-19, duke qenë se kjo fushë e siguracioneve pas vitit 2019 ka pësuar një rritje me 22.7%.

Rritja e tregut të sigurimit të jetës u mbështet kryesisht nga një prej produkteve më të vlerësuara siç është sigurimi i jetës së debitorit. Falë rritjes së kredisë bankare, ky produkt shënoi një rritje vjetore me 28.7%, ndërsa pesha e tij në tregun e sigurimit të jetës arriti në 68.3%, nga 65.1% që ka qenë në vitin 2020.

Ashtu si në Sigurimet e Jo-Jetës, edhe tek ato të Jetës, SIGAL LIFE UNIQA Group Austria është lidere në treg duke dominuar 53% të totalit. Edhe sa i përket dëmeve të paguara, SIGAL LIFE është kompania e sigurimit numër 1 në Shqipëri me 42% të totalit të dëmshpërblimeve gjatë vitit 2021. Një gjë të tillë e vërteton edhe Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL LIFE UNIQA Group, Edvin Hoxhaj, i cili ka theksuar se të ardhurat e regjistruara nga sigurimet e Jetës kontribuojnë me 14% në veprimtarinë financiare të SIGAL UNIQA.

Këto të dhëna të bëra publike së fundmi tregojnë as më shumë e as më pak se SIGAL UNIQA Group Austria është shoqëria që zë pjesën më të madhe të tregut dhe gjithashtu mban vendin e parë për dëmet e paguara. Viti 2021 shënohet si një vit tjetër suksesi i padiskutueshëm i SIGAL UNIQA, por kësaj here bindshëm edhe në sigurimin e Jetës.

## Pensionet Private, alternativa më e mirë për të ardhmen

Në një kohë kur skema e pensioneve është përfshirë në krizë, fondet e pensioneve private janë një domosdoshmëri urgjente.

Si në shumë vende Europiane në zhvillim, do jenë pikërisht ato që do të kushtëzojnë krijimin e zhvillimin e këtij tregu. Dhe në këtë drejtim, Fondi i Pensioneve Private SIGAL qëndron në pararojë.

Asetet e anëtarëve në fundin e vitit 2021 kaluan vlerën e 2 miliardë Lekëve, duke tejkaluar edhe objektivin vjetor.

Me një fokus të lartë në përmirësimin e performacës së fondit dhe në mbështetje të përmbushjes së misionit të saj, gjatë vitit 2021 Fondi SIGAL e uli tarifën e administrimit në 2,2 % të vlerës së aseteve neto.

Këto suksese pasqyrojnë arritjen edhe të një prej objektivave kryesorë të Fondit SIGAL që është njohja e pensionit vullnetar nga të gjitha grupmoshat, sipërmarrësit dhe ndërmarjet e vogla e të mesme.

Ja avantazhet e Fondit të Pensioneve Vullnetare SIGAL:

1. Pjesë e Grupit SIGAL UNIQA, një ndër grupet më të mëdhenj financiare në rajon dhe jo vetëm.
2. Lider në tregun e pensioneve private duke zotëruar rreth 45% të tij.
3. Një zgjedhje dhe zgjidhje e sigurt në një moment mjaft të rëndësishëm të problemeve që po përballlet sot sistemi i pensioneve në Shqipëri.
4. Kontributet për pension privat mund ti paguajnë individët anëtarë të Fondit, punëdhënësit e tyre, ose çdo person i tretë në emër të tyre në lekë.
5. Në rastet kur kontributi paguhet në një monedhë tjetër,

shuma e paguar konvertohet në monedhën lekë me kursin zyrtar të konvertimit valutor, të asaj dite kur bëhet pagesa.

6. Kontributi për pension mund të paguhet në baza mujore, 3-mujore, 6-mujore, vjetore dhe si shumë e menjëhershme 'single payment'.

7. Fondet e anëtarëve janë investuar në tituj shtetërorë, me maturim 7 dhe 10-vjeçarë me qëllim maksimizimin e kthimit nga investimi.

8. Kontributet dhe fitimi i realizuar nga investimi i aseteve të Fondit nuk i nënshtrohet tatimit për aq kohë sa anëtari është pjesë e tij. Kur anëtari tërhiqet atëherë aplikohet tatimi mbi të ardhurat personale.

9. Pagesa e përfitimeve ofrohet për anëtarët e Fondit në format e: 1) Pension Pleqërie të Parakohshëm; 2) Pension Pleqërie; 3) Pension Invaliditeti; 4) Pension familjar trashëgimie; 5) Pagesa të parakohshme.

10. Si anëtarë të Fondit ju do të jeni të lirë të zgjidhin mënyrën e tërheqjes së aseteve nga llogaria juaj personale në tre forma:

- 1) në mënyrë të menjëherëshme;
- 2) në mënyrë periodike si pension;
- 3) në mënyrë të parakohshme.

11. Në rast humbje jete si anëtar të Fondit, asetet e mbetura në llogarinë tuaj do t'u shpërndahen trashëgimtarëve sipas aktit të trashëgimisë.

12. Si anëtar ju do të keni gjithashtu të drejtën, që në çdo kohë, të transferoni asetet tuaja nga një fond pensioni në një tjetër, i cili administrohet nga e njëjta ose nga një shoqëri tjetër administrimi.

13. Transparencë në kohë reale përmes faqes zyrtare në internet: [www.fondisigal.com.al](http://www.fondisigal.com.al)



**Elvis Ponari**  
Administrator i Përgjithshëm i Fondit të Pensioneve Private SIGAL UNIQA



Fondi i Pensioneve Private SIGAL, prej më shumë se 10 vitesh tashmë, administron rreth 17.6 milionë euro dhe ju shërben rreth 10,000 anëtarëve, duke zotëruar 44% të tregut, me Fondin e Pensionit Vullnetar "SIGAL", e cila është një risi perëndimore prezantuar në Shqipëri për herë të parë në vitin 2006.

Me një themel të fortë ligjor dhe kapitalin e duhur, Fondi i Pensioneve "SIGAL" krijoi mundësinë dhe një vlerë të shtuar për të gjithë, për ruajtjen e standardit të jetesës në moshën e pensionit.



## SIGAL UNIQA, infrastrukturë e duhur organizative duke respektuar legjislacionin në fuqi



**Abdyl Sarja**  
Sekretar i Përgjithshëm dhe Drejtor i Departamentit legal, Compliance dhe BNJ



"Kompania ushtron aktivitetin, duke respektuar kuadrin ligjor në fuqi, me gjithë ndryshimet dhe dinamikën e tij, por dhe duke ruajtur, natyrisht, fokusin primar të saj: shpërblimin e klientëve për besimin që ata kanë investuar tek kompania, në mënyrë sa më të drejtë, të thjeshtë dhe të shpejtë. Aktiviteti i SIGAL UNIQA në nivelet e kërkesave të rregullatorit austriak dhe të ligjeve të BE-së",



SIGAL UNIQA ia ka arritur shumë mirë të jetë pasqyrë e standardeve të një tregu kërkues dhe të sofistikuar siç është ai i BE-së, nëpërmjet një sistemi shumë praktik dhe eficient bashkëpunimi të vazhdueshëm me UNIQA-n. Një histori e gjatë sukcesi e një kompanie, siç është ajo e SIGAL UNIQA përgjatë 23 viteve, kalon padyshim edhe përmes ngritjes dhe koordinimit të infrastrukturës përkatëse organizative dhe normative.

Viti që lamë pas solli edhe disa ndryshime sa i përket ligjeve të reja që hynë në fuqi dhe njëri prej tyre ishte edhe ai "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

Ligji i ri, në krahasim me kuadrin ligjor të mëparshëm i cili parashikonte vetëm një produkt të sigurimit të detyrueshëm, atë të përgjegjësive për dëmin e shkaktuar palës së tretë që rezulton nga përdorimi i mjeteve motorrike, zgjeroi gamën e produkteve të sigurimit të detyrueshëm me:

a. sigurimin e pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik i trajtuar në kapitullin II të ligjit.

b. sigurimin e përgjegjësive për dëmin e shkaktuar palës së tretë nga përdorimi i mjeteve të transportit ajror dhe mjeteve lundruese.

Krahas përafrimit me direktivat dhe standartet, përfshirja e këtij produkti është në koherencë me një nisëm tjetër ligjor "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë", në të cilën është përfshirë detyrimi për sigurimin e përgjegjësive ndaj palëve të treta që rezultojnë nga përdorimi i avionëve.

SIGAL UNIQA është gjithmonë në koherencë me ndryshimet ligjore dhe rregullatore në vend duke e ngritur të gjithë punën e saj mbi korrektësinë përballë legjislacionit në fuqi çka e ka bërë të jetë dinjitoze përballë organeve mbikqyrëse shtetërore dhe e besueshme përballë mbi 1 milion klientëve të saj.

Sipas Sekretarit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Departamentit të Legal & Compliance në SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, z. Abdyl Sarja, fokusi primar i kompanisë është respektimi i kuadrit ligjor në fuqi, pavarësisht ndryshimeve dinamike që ndodhin vazhdimisht.



## 23 vite me SIGAL, rruga e suksesit drejt një bashkëpunimi virtuoz

*"Nëse je një biznes i suksesshëm, je sepse skuadra jote është e suksesshme!"  
Magic Johnson.*

23 vite me SIGAL UNIQA Group Austria kanë krijuar një bazë të fortë në rrugën drejt suksesit, duke e kthyer në një ndër kompanitë me një rol tepër të fuqishëm në vendin tonë. Të gjitha hallkat e lidhura fort kanë ardhur si rezultat i një stafi të palodhur, profesionistë të vërtetë në fushat e tyre përkatëse, një staf i kualifikuar dhe i trajnuar nga trajnuesit më të mirë në Evropë.

Përgjatë kësaj periudhe relativisht të gjatë duhet theksuar se syri kritik në përzgjedhjen e tyre është një gur mjaft i rëndësishëm duke vlerësuar dhe faktin që kandidati i ri do të jetë përfaqësuesi yt në arenën e biznesit.

Në SIGAL UNIQA është shumë e rëndësishme që punonjësit të jenë të motivuar, të kenë kënaqësinë e bashkëpunimit me ne, ndaj kompania shpeshherë ka vendosur në dispozicioni disa metoda për të nxitur bonuse për stafin, siç është edhe së fundmi platforma Employes Sales. Filozofia e përdorimit të kësaj platforme qëndron në faktin që punonjësit mund të bëhen pjesë e shitjeve të produkteve SIGAL, pa qenë pjesë e stafit të shitjeve.

Por jo vetëm kaq. SIGAL UNIQA Group Austria tregohet shumë e kujdesshme kur bëhet

fjalë për barazinë gjinore mes stafit, duke krijuar një kulturë gjithëpërfshirëse dhe shembull edhe për shoqëritë e tjera në vend dhe jo vetëm.

SIGAL e ka kaluar me sukses këtë provë dhe ka qenë bashkëpunimi e fryma e mirë mes ekipit është ajo që e ka mbajtur gjallë funksionimin e mirë në grup.

Përveç profesionalizmit, tepër të rëndësishme janë edhe kushtet në të cilat punonjësit do të ushtrojnë afësitë e tyre. Edhe për këtë SIGAL Uniqa Group Austria kujdeset me shumë devotshmëri që të gjitha nevojat për mbarëvajtjen e procesit të punës të plotësohen. Gjithçka është e mirëmenduar, që të do të thotë se punonjësit i kanë të gjitha fasilitetet në godinën e institucionit, duke nisur që nga zyrat komode me kushte bashkëkohore evropiane, e deri te ambientet e pushimit gjatë orarit të punës. Sigurisht që asgjë nuk ka qenë e thjeshtë, por vlen të theksohet se SIGAL Uniqa Group Austria, pjesë e gjigandit të njohur të sigurimeve UNIQA ka arritur të jetë një ndër asetet më të rëndësishme dhe më të vyera në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, një trampolinë kulturash, risish dhe novacionesh që kanë rritur ndjeshëm pritshmëritë e klientëve shqiptar.



**Alma Totokoçi**  
Zv. Drejtore e Përgjithshme  
SIGAL UNIQA Group  
AUSTRIA

“

“Në kompaninë tonë barazia gjinore dhe diversiteti janë në themel të politikave tona në rekrutimin e punonjësve. Ne dëshirojmë që stafi ynë të ndjejë se janë pjesë përbërëse e komunitetit tonë, dhe së bashku kemi krijuar një kulturë gjithëpërfshirëse, ku të gjithë mund të kontribuojnë në rritjen e institucionit. SIGAL konsideron se ofrimi i mundësive të barabarta për të gjithë, diversiteti dhe promovimi i një kulture gjithëpërfshirëse është thelbësore për suksesin tonë.

”



Mbi 2000 punonjës energjikë, profesionalë dhe me eksperiencë disa-vjeçare u shërbejnë çdo ditë mbi 1 milion klientëve të SIGAL UNIQA në 3 shtete: Shqipëri - Kosovë - Maqedoni e Veriut.

Mbi 1100 zyra dhe pika shitjesh janë në dispozicion të klientëve çdo ditë, për të marrë informacione, për të blerë siguracionet që ju nevojiten si dhe për të hapur praktikën e dëmeve.

Për tu gjendur sa më pranë klientëve, hapëm Qendrën e Asistencës për të Dëmtuarit nga Aksidentet Automobilistike, për të asistuar çdo klient që të plotësojë si duhet dosjen e dokumentacionit dhe hapjen e praktikës së dëmit, me qëllim që

ta marrin në kohë dhe të plotë dëmshpërblimin që ju takon në rast dëmi nga aksidentet rrugore.

Shërbimi online është kthyer në kryefjalën e kohëve që po jetojmë, ndaj dhe ne si SIGAL UNIQA i kemi kushtuar rëndësinë e duhur, duke rritur dhe përmirësuar shërbimin online, qoftë sa i përket dhënies së informacionit klientëve në kohë reale, po ashtu edhe me shitjen e siguracioneve online.

Krahas rrjeteve sociale, të cilat janë kthyer në një urë shumë të thjeshtë dhe të shpejtë komunikimi me klientët, SIGAL UNIQA ka vendosur numra të dedikuar 24 orë çdo ditë të javës për komunikimin me Whatsapp dhe telefonata me klientët.

## Aftësia paguese dhe stabiliteti financiar i SIGAL UNIQA Group Austria

Aftësia paguese e SIGAL UNIQA Group Austria është solide dhe në tejkallim të kërkesave ligjore që ka Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare dhe konform standarteve europiane.

AMF ka vlerësuar mjaftueshmërinë dhe tejkallimin e kërkesave ligjore të kapitalit të kompanisë në masën 130% (Deri më: 31.12.2020) dhe 208.2% (Deri më: 31.03.2021).

Provizionet Teknike për periudhën 31 dhjetor 2020 ishin në masën 125.26%, ndërsa për periudhën 31 mars 2021 ishin në masën 126.3%, ku AMF vlerëson mjaftueshmërinë në mbulimin e Rezervave Financiare dhe përmbushjen maksimalisht të të gjitha detyrimeve ligjore nga SIGAL UNIQA Group AUSTRIA.

SIGAL UNIQA vijon të kryesojë vlerësimin dhe renditjen e klientëve and partnerëve të saj jo vetëm si kompania më e madhe e sigurimeve në vend, por si siguroesi më i besuar, më i përgjegjshëm dhe më i qëndrueshëm.

Treguesit e likuiditetit tregojnë nivelet e parasë së një kompanie dhe aftësinë për të kthyer aktivet e tjera në para për të paguar

detyrimet dhe detyrimet e tjera afatshkurtra.

Aftësia paguese dhe rezervat teknike janë treguesit themelorë për një kompani sigurimi, të cilat çdo qytetar duhet ti shohë me vëmendje para se të sigurohet.

Një shoqëri sigurimi është solvente, nëse është e aftë të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga të gjitha kontratat nën të gjitha rrethanat e mundshme të parashikueshme.

Parimet për Mjaftueshmërinë e Kapitalit dhe Aftësinë Paguese janë thelbësore për vlerësimin e aftësisë paguese si të shoqërive të sigurimit të jetës ashtu dhe për ato të jo jetës.

Dhe sigurisht që në këtë drejtim, SIGAL UNIQA është kompania shembull në Shqipëri dhe jo vetëm.



**Klement Mersini**  
Drejtore i Departamentit të Financës

“

Financat e qëndrueshme, një pozicion i shëndetshëm i aftësisë paguese dhe përfaqja proaktive ndaj risqeve janë në bazë të të gjitha veprimeve të biznesit të SIGAL UNIQA dhe përbëjnë themelet e misionit tonë për të mbështetur “një jetë më të sigurt, më të mirë dhe me të gjatë” për të gjithë klientët, punonjësit dhe aksionerët tanë”.

”

## Aktuaristika, ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatet dhe qëndrueshmërinë financiare që SIGAL UNIQA gëzon sot

Vlerësimi i rrezikut në sigurime është një proces gjithëpërfshirës i analizave dhe evoluimit të rrezikut.

Departamenti i Aktuaristikës në SIGAL UNIQA jep kontributin e tij në menaxhimin e riskut bazuar në aftësitë dhe formimin e pjesëtarëve të saj në fushën e matematikës, statistikës dhe financës.

Ky departament është përgjegjës për llogaritjen e provigjioneve të sigurimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi, llogaritjen

e marzhit të aftësisë paguese, jep kontributin në përgatitjen e drafteve të kushteve dhe termave të policave të sigurimit, llogaritjen e primeve dhe përfitimeve, hartimin e politikës së risigurimeve të shoqërisë, kryerjen e testeve të gjendjes financiare të shoqërisë, etj.

Siç shprehet edhe drejtori i tij, z.Arben Çavolli, ky Departament kanë ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin, qëndrueshmërinë financiare dhe kushtet ekonomike të shëndosha që SIGAL UNIQA gëzon sot.




**Arben Çavolli**  
Drejtore i Departamentit të Aktuaristikës

“

Objekti i punës së Departamentit të Aktuaristikës është llogaritja dhe analizimi i treguesve jetikë të veprimtarisë së SIGAL UNIQA Group AUSTRIA. Gjithashtu në misionin e këtij Departamenti janë edhe parashikimet për detyrimet që SIGAL UNIQA do të ketë në të ardhmen për dëmet, llogaritja e marzhit të aftësisë paguese, vlerësimi i rreziqeve dhe sigurimi i tyre për periudha afatgjata.

”



## Marrëdhëniet pozitive me UNIQA Insurance Group, jetike për zhvillimin e SIGAL

Prej vitit 2007, gjigandi austriak i sigurimeve UNIQA Insurance Group është aksioneri më i madh i SIGAL duke i dhënë një hov të ri tregut të sigurimeve në Shqipëri dhe rajon.

Ky partneritet i shkëlqyer e rendit SIGAL UNIQA Group Austria si kompaninë lider më të suksesshme, më të madhe dhe më të besuar në sigurimet Jo Jetë dhe Jetë, i vlerësuar si i tillë nga rrjeti i

klientëve dhe partnerëve të saj. Por ruajtja e pozicionit të liderit në treg vjen edhe si pasojë e ruajtjes së marrëdhënieve pozitive, ndershmërisë dhe transparencës me aksionerin tonë më të madh.

Për këtë arsye, SIGAL UNIQA Group Austria ka në përbërje të saj edhe një koordinatore dedikuar komunikimit me UNIQA Insurance Group.




**Rugova Çokaj**  
Kordinatore me Aksionerin UNIQA dhe Drejtore e Departamentit të Regresit

“Marrëdhëniet pozitive me partnerin tonë kyç të biznesit UNIQA Insurance Group janë jetike për zhvillimin e kompanisë. Komunikimi është një nga aspektet më sfiduese dhe më të rëndësishme në raportin e krijuar me partnerët tanë, raport që ka rezultuar në një marrëdhënie biznesi afatgjatë dhe të qëndrueshme. Mbi të gjitha, ne jemi të angazhuar për ndershmëri dhe transparencë në marrëdhëniet tona të biznesit me UNIQA.”



# 48 PRODUKTE

## Një botë me siguracione



## SIGAL UNIQA promotore e produkteve të siguracionit të pasurisë

Puna e palodhur e specialistëve të SIGAL UNIQA Group Austria për trajtimin e dëmeve të shkaktuara nga trumeti fatkeq i vitit 2019 në banesa dhe në biznese, ka rritur sensibilizimin të qytetarëve shqiptarë që tregojnë pronat, por pavarësisht kësaj kaq nuk mjafton.

Sipas të dhënave zyrtare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në portofolat e Pronës, Përgjegjësisë, Garancive gjatë vitit 2021 siguruan mbi 3,4 miliardë lekë, apo rreth 34 milionë dollarë, të ardhura në total ku vendin e parë e zënë Zjarri dhe Dëmtime të Tjera në Pronë me rreth 59.56%, të pasuara nga sigurimi i Përgjegjësisë së Përgjithshme me 30.76% të totalit.

Sipas raportit vjetor për vitin 2021, SIGAL UNIQA mbetet kompania lidere në tregun vendas dhe jo vetëm që

dominon sigurimet e Pronës me rreth 40%. E përkthyer në shifra, vetëm në kategorinë "Pasuria" ka paguar plot 3.5 miliardë lekë dëme, nga të cilat rreth 3 miliardë kanë qenë pikërisht për klientë që kishin siguruar pronat e tyre kundër Zjarrit.

Kjo shifër kolosale do të thotë rikthim në gjendjen e mëparshme të qindra shtëpive, të dhjetëra biznese dhe mundësimin e vazhdimin të jetës normale njëlojë siç e kishin para se të ndodhte fatkeqësia. Kostoja financiare e Sigurimit të Pronës është e përballeshme nga të gjitha shtresat e shoqërisë pasi kompania më e madhe e sigurimeve në vend, SIGAL UNIQA Group Austria e ofron Sigurimin e banesës apo biznesit me një kosto duke nisur nga 0.5 euro për m<sup>2</sup>.



**Ogert Shkrepa**  
Drejtor i Departamentit të Pasurisë dhe Garancive

“

Edhe për sigurimin e pronës në Shqipëri gjatë vitit 2021, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA u vlerësua si kompania më e madhe dhe më e besuar. Raporti vjetor i AMF tregon qartë besueshmërinë që shqiptarët kanë ndaj kompanisë sonë, e cila rezultoi kompania e sigurimit që udhëheq sigurimet e pronës me rreth 40% të tij. Gjithashtu, nuk duhet harruar fakti se, gjatë vitit 2021, SIGAL UNIQA vetëm në Sigurimet e Pronës ka paguar rreth 3.5 miliardë lekë dëme,

”

## Në celularin e çdo shqiptari me Teleshëndet



Teleshëndet është një shërbim që mundëson takimet me video apo nëpërmjet një telefonate me pacientin dhe doktorin, duke u cilësuar kështu si një avantazh për përdoruesit e aplikacionit. Sot pacientët mund ta përdorin platformën Teleshëndet përmes aparateve teknologjike vetëm me një klik, duke siguruar kështu për veten rehatinë, përshtatshmërinë, kontrollin më të shpeshtë të mjekësorisë, shërbimin e specializuar të stafit profesional mjekësor në kohë reale.

“Parandalimi është më i mirë se sa kurimi!” Kjo është motoja me të cilën SIGAL UNIQA Group Austria punon për t’u ardhur në ndihmë qytetarëve me paketat më të mira të Sigurimit të Shëndetit.

Vitet e fundit me përbaljen me pandeminë, rëndësia që ka pasur shëndeti ka nisur të vlerësohet më tepër, duke rritur interesin e qytetarëve për më shumë paketa që lidhen me këtë. Në një situatë të tillë frike dhe pasigurie, SIGAL UNIQA arriti të merrte në dorë tregun me risitë më të reja, siç ishte lançimi në treg i shërbimit mjekësor dhe teknologjik mjaft të avancuar, Teleshëndet.



**Milena Merjemaj**  
Drejtoreshë e Departamentit të Shëndetit dhe Aksidentëve

“

Në punën tonë të përditshme ne i tregojmë klientëve që na kontaktojnë dhe takojmë se të qenit i siguruar është alternativa më ekonomike për t’u kujdesur për shëndetin në afatgjatë. Në mënyrën e të punuarit, preferojmë novacionin dhe ndjekim ritmin e praktikave të siguruesve më të fuqishëm në botë. Pagesa e faturave mjekësore në kohë nuk mund të mbetet përgjigjja e vetme ndaj nevojave të të siguruarve tanë. Prandaj, sot jemi në telefonin e çdo të siguruarit me platformën “Teleshëndet”. Kjo platformë i dedikohet çdo klienti që beson në vizionin e SIGAL pa limit moshe, prandaj ta shkarkosh është një ftesë dhe një sugjerim,

”

Teleshëndet nuk ka asnjë limit moshe, gjë që e bën atë më të thjeshtë për t’u aksesuar nga të gjithë. Të njëjtën gjë konfirmon edhe drejtoresha e Departamentit të Shëndetit, Milena Merjemaj.

SIGAL UNIQA Group Austria është e para kompani që sjell në Shqipëri një risi të kësaj kategorie. Tashmë pa u shqetësuar për rrugën apo kohën e humbur në radhë të gjata, me vetëm një shkarkim ti mund të sigurosh konsultë me mjekun apo deri edhe të dhënia e recetës vetëm përmes telefonit. Çdo klient i “Teleshëndet” mund të konsultojë përgjigjet e analizave, çek-up, grafi apo ekzaminime të tjera dhe të marrë në kohë reale këshillën që i duhet për tu bërë më mirë apo edhe recetën nëse nevojitet.

Ndaj nëse ke telefonin me vete ke edhe doktorin me vete 24 orë. Teleshëndeti është e ardhmja, është pjesë e botës dixhitale dhe SIGAL Uniqa është gjithmonë pranë inovacioneve të reja, sepse SIGAL është gjithmonë pranë klientëve.



## SIGAL Uniqa kompani lider në sigurimin e mjeteve

SIGAL UNIQA Group Austria vijon të mbetet shoqëria më e besuar e sigurimeve në Shqipëri, e kjo edhe në një kohë kur kurba e aksidenteve rrugore ka pësuar një rritje të frikshme.

Raportet e AMF-së tregojnë se SIGAL UNIQA është aktualisht kompania më serioze në tregun shqiptar, duke iu referuar edhe primeve të shitura por edhe dëmeve të paguara dhe kjo pikërisht për faktin se ofron mundësi të shumta kombinimi, ku klientët mund të marrin siguracion full kasko, kasko light apo mini kasko në varësi të mundësive apo dëmeve që duan të mbulojnë.

Vetëm në vitin 2021, SIGAL UNIQA, për sigurimin kasko ka paguar plot 1.8 miliardë Lekë dëme me një mesatare dëmi prej 138,055 Lekësh. Riparime në servise të specializuara janë paguar rreth 1.2 miliardë Lekë, ndërsa pagesa të drejtpërdrejta te klienti mbi 640 milionë Lekë. Këtë e ka pranuar edhe Drejtori i Departamentit Motorik, Besnik


Çobaj i cili tregoi si kompania jonë e sigurimeve ka arritur të kryesojë tregun me rreth 22% të totalit, si kompania e parë në marrjen në sigurim dhe në pagesën e dëmeve përgjatë vitit që lamë pas.

Klienti është gjithmonë fokusi i SIGAL UNIQA, ndaj edhe sensibilizimi i tyre për sigurimet, nevojat për të qenë i sigurtë ndaj ndodhive apo fatkeqësive të papritura është tepër i rëndësishëm. Por me sigurimin KASKO, ku garant është dëmshpërblimi në kohë rekord dhe riparimi i automjetit në servise të specializuara, sigurisht që besimi ndaj SIGAL UNIQA Group Austria mbetet i madh.

Gjithashtu edhe futja në skemë e mbulimit financiarisht të dëmeve edhe nëse makina dëmtohet në parkim, dëmtohet nga zjarri, rrufeja ose shpërthimi, nga fatkeqësitë natyrore apo nga dëmtimet aksidentale është

një plus i madh në tregun e ashpër të siguracioneve

Por sa serioze dhe korrekte një kompani sigurimi kuptohet nga dëmet që paguan dhe SIGAL UNIQA është krenare të thotë se është lidere në këtë drejtim.



**Besnik Çobaj**  
Drejtor i Departamentit Motorik

“

Sigurimet motorike të shqiptarëve edhe përgjatë vitit 2021 i besohen SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, kompania që kryeson tregun me rreth 22% të totalit. SIGAL UNIQA është gjithashtu kompania lidere edhe sa i përket dëmeve më të paguara me 27%, duke shënuar një rritje me 7% krahasuar me vitin 2020. Ne jemi të parët në marrjen në sigurim dhe në pagesën e dëmeve gjatë vitit 2021.

”

## SIGAL UNIQA e vetmja kompani sigurimi në Shqipëri që ofron të gjitha produktet e Marinës

SIGAL u themelua në vitin 1999 dhe në të njëjtin vit u përball me dëme të konsiderueshme të ndodhura në sigurimin e Marinës (transport detar) duke kryer menjëherë procedurat e dëmshpërblimit dhe duke rritur kështu sigurinë dhe besimin tek klientët e saj.

Ndërkohë, SIGAL bëri të mundur zgjerimin e tregut të sigurimeve të Marinës në Shqipëri, falë bashkëpunimit që lidhi me klubet lundruese të Marinës P&G (west of England Steamship), duke u bërë përfaqësuesi i tyre i autorizuar për Shqipërinë.

UNIQA Re, si edhe nga brokerat më të mirë në tregun e Londrës. Përvojat dhe kontratat e ofruara nga SIGAL UNIQA garantojnë vazhdimësinë e biznesit për të mbyllur me sukses marrëveshjet, për të shmangur humbjet nga rreziqet dhe të papriturat e ndryshme gjatë transportit.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA është e vetmja kompani sigurimi në Shqipëri që ofron të gjitha produktet e Marinës, si P&I dhe H&M e mbështetur nga

Raportimet bëhen të gjitha online nga kompjuteri apo celulari. Gjithashtu, sigurimi i mjeteve lundruese mund të blihet totalisht online.



**Erald Hysa**  
Drejtor i Departamentit të Marinës dhe Aviacionit

“

“Departamenti i Sigurimit të Marinës dhe Aviacionit, asiston dhe këshillon bizneset shqiptare që merren me import/export nga e gjithë bota, pasi distancat e largta në rrugë tokësore, detare apo ajrore që nga nisja e deri në destinacion, bëjnë që mallrat gjatë transportit të jenë të ekspozuara për një kohë të gjatë ndaj rreziqeve të shumta aksidentale të mjetit apo dhe të fatkeqësive natyrore. Angazhimi ynë është kalimi i të gjitha produkteve online, si për operatorët e sektorit të transportit, ashtu edhe për klientët përfundimtar.

”

## Blerje Online dhe transformimi rrënjësor i industrisë tradicionale të sigurimeve

Të vetëdijshëm për ndryshimet që dikton koha, ne si SIGAL UNIQA i kemi paraprirë ndryshimeve duke investuar dhe zhvilluar teknologjinë.

SIGAL UNIQA ishte e para kompani në Shqipëri e cila realizoi blerjen online të siguracioneve nga celulari ose kompjuteri, nga kudo ku klientët ndodhen.

Aktualisht në faqen zyrtare të SIGAL UNIQA ([www.sigal.com.al](http://www.sigal.com.al)) numërohen mbi 10 produkte sigurimi që mund të blihen online dhe po punohet që të gjitha produktet (SIGAL UNIQA numëron mbi 43 produkte sigurimi) të shiten edhe online.

Krahas blerjes së siguracioneve online, klientët e SIGAL UNIQA, mund të marrin në faqen zyrtare online si dhe në aplikacionin mobile të gjitha informacionet që iu nevojiten mbi sigurimet si dhe të hapin praktikat për dëmshpërblim në rast aksidenti apo dëmi shëndetësor.

Produktet që mund të porositen ose blihen online nga SIGAL UNIQA:

- ✔ Sigurim TPL
- ✔ Kartoni Jeshil
- ✔ Polica Kufitare
- ✔ Sigurimi i Pronës
- ✔ Sigurimi i Mjeteve Lundruese
- ✔ Sigurimi i Shëndetit në Udhëtim
- ✔ Sigurimi i Shëndetit në Udhëtim për të Huajt
- ✔ Sigurimi i Nxënësve dhe Studentëve
- ✔ Sigurimi i Studentëve jashtë Shqipërisë
- ✔ Sigurimi COVID 19
- ✔ Sigurimet e Shëndetit
- ✔ Teleshëndet



**Lorenc Tabaku**  
Drejtore i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit



Rëndësia e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit në ditët e sotme është jetike në industrinë e sigurimeve. Kryefjala e ditëve të sotme është InsurTech ku një sërë teknologjish janë krijuar për të transformuar rrënjësisht industrinë tradicionale të sigurimeve. SIGAL UNIQA prej më shumë sesa 5 vjetësh ka hyrë në një fazë transformimi dixhital kapilar për të ofruar komoditet, siguri, zgjedhje dhe zgjidhjet më të mira për të gjithë klientët tanë. Me zgjidhjet tona efektive teknologjike, ne kemi fituar avantazhin konkurrues në tregun e sigurimeve në vend dhe më gjerë në rajon, duke ofruar kanale të shumta dixhitale për ndërveprim me klientët, duke gjeneruar inteligjencë biznesi dhe inovacion teknologjik për të ardhmen. Sfidat tona të përditshme është plotësimi dhe krijimi i kushteve me teknologjitë më bashkëkohore për SIGAL UNIQA.



## Çfarë siguracioni të duhet?

Bli direkt nga celulari siguracionet që të duhen.

Dhe nëse je i siguruar tashmë, informohu në kohë rekord se si të veprosh në rast dëmi

✔ Thjesht    ✔ Shpejt    ✔ Sigurt



[sigal.com.al](http://sigal.com.al)

# Viti 2021, një tjetër vit sukcesi/ Asnjë kompani nuk ka paguar sa SIGAL UNIQA

Kompanitë e sigurimeve paguan afërsisht 6.7 miliardë lekë ose 55 milionë euro dëme gjatë vitit 2021.

Shifrat janë marrë nga raporti vjetor mbi ecurinë e tregut të sigurimeve, publikuar dje nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF).

Kthimi në normalitet bëri që struktura e dëmeve vitin e kaluar të dominohej sërish nga sigurimet e detyrueshme motorike, për përgjegjësitë ndaj palëve të treta. Dëmet në këto klasa u rritën me 20.3% krahasuar me vitin 2020. Pesha e tyre në strukturën e dëmeve të paguara bruto arriti në 53.5%, nga 39.2% që kishte qenë një vit më parë.

Vitin e kaluar, aksidentet rrugore në Shqipëri u rritën me 11.5% dhe kjo rritje është reflektuar edhe në shtimin e dëmeve të paguara nga siguruesit.

Rritje e dëmeve u shënuar edhe në sigurimin vullnetar KASKO të mjeteve tokësore, me 20% më shumë krahasuar me vitin 2020.

Rritje e dëmeve të paguara gjatë vitit të kaluar u shënuar edhe në shumicën e klasave të sigurimeve vullnetare.

Dëmet në produktin e sigurimit të sëmundjeve u rritën me

22.4% ku duket se Covid-19 dhe pasojat që la në shëndetin e njerëzve kanë ndikuar në shtimin e dëmeve nga Sigurimet e Shëndetit.

Në tregun e Sigurimit të Jetës dëmet pësuan një rritje të ndjeshme, me 31.7% më shumë krahasuar me një vit më parë. Ky treg i ndjeu më së shumti efektet e rritjes së numrit të vdekjeve për shkak të pandemisë gjatë vitit të kaluar.

Por cila është kompania e sigurimeve në Shqipëri që ka paguar më shumë dëme gjatë vitit 2021?

Shifrat e publikuara nga AMF tregojnë qartë dominancën e SIGAL UNIQA Group Austria si kompania që jo vetëm ka besimin më të madh tek shqiptarët duke zënë pjesën më të madhe të tregut por edhe sa i përket dëmeve të paguara.

**SIGAL UNIQA Group Austria, lidere prej 23 vjetësh**





Si grupi më i madh i sigurimeve në Shqipëri dhe rajon SIGAL UNIQA Group Austria është krenare që besohet nga më shumë se 1 milion klientë dhe që shifrat e saj janë në rritje vit pas viti, pavarësisht sfidave që sjell koha.

Të përkushtuar dhe me profesionalizëm, afro 2000 punonjës dhe agjentë të SIGAL UNIQA shërbejnë 48 produktet tona në rreth 1200 zyra në 3 shtete, me standarte tërësisht europiane.

SIGAL UNIQA, pjesë e gjigandit austriak të sigurimeve UNIQA Insurance Group, prej 23 vitesh, me punën saj, kërkon të frymëzojë, të sjellë vlera dhe risi për klientët e saj dhe jo vetëm produkte.


Mbi 121 milionë euro asete dhe më shumë se 400 milionë euro dëme të paguara ndër vite, janë dëshmia më e madhe e fuqisë, përgjegjshmërisë dhe korrektësisë sonë përballë klientëve.

## Sipas Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare Tregu i Sigurimeve dhe Dëmet e Paguara për vitin 2021



Burimi AMF: Raporti Janar-Dhjetor 2021

## % e SIGAL UNIQA në tregun e sigurimeve sipas produkteve për vitin 2021



# Korrektësia ndaj klientëve dhe pagimi i dëmeve në kohë, çelësi i suksesit për SIGAL UNIQA Group Austria

SIGAL UNIQA Group Austria feston 23-vjetorin e themelimit, krenare se gjatë gjithë këtyre viteve ka udhëhequr tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe jo vetëm. Një nga arsyt kryesore për arritjen e rezultateve të tilla është edhe korrektësia me klientët dhe pagesa e dëmeve në kohë dhe konform ligjeve në fuqi. Shërbimi i shpejtë ndaj

klientëve, zbatimi i protokollit të dëmeve, verifikimi i dokumentacionit të policisë për ngjarjen, vërtetësia e rastit, ndarja e përgjegjësisë në aksident dhe vlerësimi real i dëmit janë arsyt kryesore pse qytetarët i besojnë masivisht siguracionin e automjetit pikërisht SIGAL UNIQA Group Austria-s.



**Kastriot Bejkollari**  
Drejtor i Departamentit të Dëmeve TPL



“Rëndësi të veçantë ka trajtimi me kujdes i kërkesave për dëmshpërblim për dëme materiale, duke përfshirë: shërbimin e shpejtë ndaj klientëve brenda afateve kohore, zbatimin e protokollit të dëmeve, verifikimin e dokumentacionit të policisë për ngjarjen, vërtetësia e rastit, ndarja e përgjegjësisë në aksident dhe vlerësimi real i dëmit.

Dëmet TPL janë rritur nga viti në vit. Parashikimi deri në fund të vitit 2021 për dëme materiale shkon rreth 3,600 raste. Objektivi ynë është: minimizimi i rasteve abuzive dhe i mashtrimeve në sigurime në bashkëpunim me Departamentin Ligjor. Synimi ynë ekonomik është të kursejmë sa më shumë kohë në pagesën e dëmeve materiale nëpërmjet shërbimit të shpejtë dhe profesional”



Dëmet e Paguara për vitin 2021 SIGAL UNIQA Group Austria			
Nr	Llojet e Sigurimeve	Nr.	Total Leke
<b>I</b>	<b>Pasuria</b>	<b>152</b>	<b>350,098,251</b>
1	Zjarri	145	298,049,029
2	CAR	0	0
3	G. Oferte	0	0
4	G. Kontrate	2	41,126,925
5	Banka CIS-CIT	0	0
6	Pergjegjesi	4	2,424,450
7	Bujqesi&Blegtori	1	8,497,847
<b>II</b>	<b>M. Motorike</b>	<b>5,189</b>	<b>1,075,656,717</b>
1	TPL	3,443	699,693,406
2	KASKO	1,276	176,370,569
3	Mini Kasko	359	17,383,704
4	Kufitare	25	9,871,200
5	K. Jeshil	86	172,337,838
<b>III</b>	<b>K. Jeshil&amp;Shendet</b>	<b>11,523</b>	<b>289,232,149</b>
1	Shendet në udhëtim	63	4,524,150
2	Aks. Personale	121	14,610,583
3	Shendet privat	11,339	270,097,416
<b>IV</b>	<b>Marine&amp;Aviacion</b>	<b>10</b>	<b>2,279,420</b>
1	H & M	0	0
2	P & I	0	0
3	Mall Transport	10	2,279,420
4	Avione	0	0
<b>Total</b>		<b>16,874</b>	<b>1,717,266,537</b>

Por përveç siguracionit të detyruar TPL, SIGAL UNIQA ka sjellë për klientët e saj edhe Sigurimin KASKO, i cili mbron automjetet e tyre edhe kur ata janë shkaktarë të aksidentit.

Në Siguracionet TPL, Kasko dhe MiniKasko, gjatë vitit 2021, SIGAL UNIQA ka paguar mbi 7.5 milionë euro dëme te klientët e saj duke u rënditur edhe nga AMF si kompania që paguan më shumë.




**Florant Lumani**  
Drejtor i Departamentit të Dëmeve KASKO



“Një kompani e suksesshme sigurimi vlerësohet nga trajtimi dhe pagesa e dëmeve. Departamenti i Trajtitimit të Dëmeve Motorrike KASKO ka si objektiv trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim të klientëve të siguruar me policë Sigurimi Kasko, në një kohë sa më të shkurtër dhe me korrektësi maksimale.

Gjithashtu klientëve me flota mjeteve të siguruara me Siguracion Kasko i kemi krijuar lehtësira për procedurën e kërkesës për dëmshpërblim, duke u kursyer sa më shumë kohë. SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, kompania e parë në pagesën e dëmeve!”



Burimi AMF: Raporti Janar-Dhjetor 2021

Dëmet e Paguara në Sigurimin Motorik Paid Claims in Motor Insurance	
Shoqëria e sigurimit Insurance company	Vlera (në mijë lekë) Value (in thous.ALL)
<b>Viti/ Year</b> <b>2021</b>	
<b>Dëme të paguara Bruto / Gross Paid Claims</b>	
Sigal Uniqa Group Austria	1,075,657
Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group	592,936
Intersig Vienna Insurance Group	515,161
Albsig	511,917
Eurosig	409,163
Ansig	337,357
Atlantik	278,820
Insig	264,864
<b>TOTAL</b>	<b>3,985,873</b>

Burimi AMF: Raporti Janar-Dhjetor 2021





## “Kartoni Jeshil”, SIGAL UNIQA ju mbron edhe kur udhëtoni jashtë Shqipërisë

### Ditika Kruja

Drejtoreshë  
Departamenti i Dëmeve  
Karton Jeshil



“Korrektësia ndaj klientëve dhe pagimi i dëmeve në kohë, çelësi i suksesit për SIGAL UNIQA Group Austria. Dëmet e ndodhura të Kartonit Jeshil do të trajtohen sipas ligjit dhe rregullave të territorit ku ka ndodhur ngjarja, e miratuar nga “Byroja Ndërkombëtare e Kartonit Jeshil”.

Serioziteti i treguar në shërbimin ndaj klientëve gjatë 23 viteve të ekzistencës së kompanisë janë arsye kryesore pse qytetarët i besojnë masivisht siguracionin e automjetit pikërisht SIGAL UNIQA Group Austria-s, edhe kur udhëtojnë jashtë kufijve të Shqipërisë.

Si asnjë kompani tjetër sigurimi në Shqipëri, gjatë vitit 2021 vetëm në klasën “Karton Jeshil” kompania jonë ka paguar mbi 172 milionë lekë ose rreth 1.5 milionë euro dëme”



“Kartoni Jeshil” është ndodhur rasti në sigurim. siguracioni i detyrueshëm për të gjitha mjetet me targa shqiptare që qarkullojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Mosnjohja e rrugëve në shtetet ku shkojmë dhe arsye të tjera mund të sjellin dëme të ndryshme dhe të konsiderueshme, ndaj të pasurit e “Kartonit Jeshil” kur udhëtoni jashtë vendit për punë apo arsye familjare është e domosdoshme dhe e detyrueshme në të gjitha pikat e kalimit kufitar. Nëse nuk e keni këtë police ju nuk mund të dilni jashtë territorit të Shqipërisë, përjashtuar këtu vetëm Kosovën.

Kohëzgjatja e “Kartonit Jeshil” mund të jetë 15 ditë, 1 muaj, 3 muaj, 6 muaj ose 1 vit, ndërsa ky siguracion mbulon përgjegjësinë civile të mbajtësit të mjetit, ndaj dëmeve që u shkakton palëve të treta, në përputhje me parashikimin e Ligjit të një prej shteteve anëtare të Këshillit të Byrove, ku ka

ndodhur rasti në sigurim. Shtetet anëtare të Sistemit ku vlen Kartoni Jeshil dhe me të cilat kompania SIGAL UNIQA Group Austria ka marrëdhënie të shkëlqyera bashkëpunimi, janë:

Belgjikë, Zvicër, Republika Çeke, Danimarkë, Francë, Finlandë, Mbretëri e Bashkuar, Greqi, Irlandë, Luksemburg, Norvegji, Holandë, Suedi, Sllovakia, Gjermani, Itali, Spanjë, Hungari, Portugali, Serbi, Austri, Poloni, Turqi, Rumani, Izrael, Marok, Tunizi, Islandë, Bullgari, Maltë, Estoni, Kroaci, Slloveni, Maqedoni e Veriut, Bosnje Hercegovina, Andorra, Qipro, Moldavi, Ukrainë, Letoni, Bjellorusi, Lituani, Rusi, Mali i Zi, Azerbajxhan.

### DËMET E PAGUARA


“Kartoni Jeshil”, për një afat 15-ditor, kushton vetëm 40 euro, ndërsa dëmi më i madh, paguar së fundmi, ka qenë plot 1.6 milion euro. Rezerva e dëmit për këtë kategori është 11.574.481



euro për 1105 dëme, çka do të thotë mesatarisht 11 mijë euro për dëm.

### NDARJA E TREGUT NË SHQIPËRI

Sipas raportit vjetor të AMF, në periudhën janar-dhjetor 2021 ky produkt ka pësuar rritje, ndërsa kompania që zotëron pjesën më të madhe të tregut dhe që paguan më shumë dëme është pikërisht SIGAL UNIQA Group Austria.



Burimi AMF: Raporti Janar-Dhjetor 2021

### Dëmet e Paguara në Sigurimin Kartoni Jeshil Paid Claims in Green Card Insurance

Shoqëria e sigurimit Insurance company	Vlera (në mijë lekë) Value (in thous.ALL)	Ndryshimi (në %) Change (in %)	Pjesa ndaj Totalit (në %) Share in total value (in %)		
			2020	2021	
<b>Viti/ Year</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>21/20-1</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>
<b>Dëme të Paguara Bruto / Gross Paid Claims</b>					
Sigal Uniqa Group Austria	96,063	172,338	79.40	16.85	37.46
Intersig Vienna Insurance Group	60,027	110,818	84.61	10.53	24.09
Eurosig	77,200	54,816	(28.99)	13.54	11.91
Insig	57,528	42,664	(25.84)	10.09	9.27
Sigma Interallbanian Vienna Insurance Group	101,853	34,888	(65.75)	17.86	7.58
Albsig	143,571	30,144	(79.00)	25.18	6.55
Ansig	11,748	14,430	22.83	2.06	3.14
Atlantik	22,277	-	(100.00)	3.91	0.00
<b>TOTAL</b>	<b>570,268</b>	<b>460,098</b>	<b>(19.32)</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>

Burimi AMF: Raporti Janar-Dhjetor 2021

# SIGAL UNIQA Group Austria “rrëmben” tregun e Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut

Kompania e sigurimeve SIGAL UNIQA Group Austria prej më shumë se 18 vitesh ka shënuar suksese të jashtëzakonshme, duke u renditur në listën e kompanive lider edhe në Kosovë e Maqedoninë e Veriut përse i përket tregut të sigurimeve. Me shifrat e raportuara në fund të vitit 2021, SIGAL Uniqa në Kosovë dhe në Maqedoni shënojnë arritjen e qëllimeve të vendosura, falë ofrimit të një game të gjerë produktesh për të gjitha fushat e sigurimit të jetës.

Transparenca dhe gadishmëria e SIGAL UNIQA ndaj klientëve sigurisht që janë dy gurët më të rëndësishëm të themelimit të suksesit të kompanisë. Sot UNIQA Group Austria renditet në vendin e 62-të në Evropën Juglindore sa i përket kompanive të sigurimit.

## Kosovë:

Me një eksperiencë të gjatë prej më shumë se 18 vitesh, SIGAL Kosova ka qenë mbështetëse e qindrave veprimtarive. Tregu i sigurimeve në Kosovë ka ndjekur një trend të ngjashëm me atë të Shqipërisë, i fokusuar te sigurimet e detyrueshme motorike, e vetëm vitet e fundit po zgjerohet edhe në sigurimet vullnetare. SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Kosova u krijua në vitin 2003 duke shënuar zbatimin e strategjisë për ndërkombëtarizim të aktivitetit sigurues.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Kosova renditet para në tregun e sigurimeve të Jo Jetës duke zotëruar 12.50% dhe 29.61 % për sigurimet e Jetës. SIGAL UNIQA Kosova ka shtrirë shërbimin e saj si

për nga numri i produkteve që ofron, ashtu edhe gjeografikisht përmes dhjetëra degëve dhe agjencive të veta në gjithë Kosovën.

Viti 2022 pritet të shënojë një tjetër vit suksesi për SIGAL Uniqa Group Austria në rajon. Besueshmëria e qytetarëve dhe korrektesa e kompanisë e ka mbajtur të gjallë frymën e dëshirës për të ecur më të sigurt drejt së ardhmes.



**Saimir Dhamo**  
CEO i SIGAL UNIQA Group Austria Kosovë





Që me krijimin në tetor 2003, shoqëria e sigurimeve SIGAL UNIQA Group AUSTRIA KOSOVË është lider në tregun e sigurimeve në Kosovë, ku aktualisht jemi në vendin e 1-rë me 12,65% të tregut. Kjo është arritur duke pasur primare shërbimin ndaj klientëve, pagesën e dëmeve në kohë, duke krijuar kështu një klientelë besnike që na lejon edhe në vazhdimësi të rrisim cilësinë tonë të ofertës së sigurimeve duke pasur një portofol të ekuilibruar të sigurimeve vullnetare me jo vullnetare. Kjo është arritur me një staf të përkushtuar dhe të trajnuar për të ofruar tek klientët produktet më novatore të tregut të sigurimeve.



**Përparim Drini**  
CEO i SIGAL Life UNIQA Group Austria Kosovë



“Që nga viti 2011, SIGAL LIFE UNIQA Group Austria në Kosovë si shoqëri e sigurimit të jetës, për klientët ka ofruar produktet më të veçanta dhe inovative në tregun e sigurimit të jetës, duke sjellë në Kosovë një përvojë të gjatë edhe nga kompanitë simotra siç janë UNIQA Group Austria dhe SIGAL UNIQA në Shqipëri. Sigurimet e jetës që ofron SIGAL Life në Kosovë kanë bërë që për një periudhë të shpejtë SIGAL Life të ketë rreth 35% të primit të sigurimeve të jetës në treg, ndërsa në nivel klientësh, administrojmë me mbi 25 mijë klientë apo rreth 70% të tregut të përgjithshëm. Me trendin e rritjes së shpejtë, SIGAL Life në Kosovë do jetë lider në sigurimet e jetës. Po ashtu si shoqëri e sigurimit të jetës ne i kemi kushtuar rendësi të veçantë vlerësimit të riskut dhe stabilitetit financiar. Në këtë kuptim, SIGAL Life, si pjesë e grupit SIGAL UNIQA, është ndër shoqëritë e sigurimit me nivelin më të lartë të mjaftueshmerisë së kapitalit dhe mbuleshmerisë së rezervave në Kosovë.”



Dëme të paguara (2003-2021)	Vlera (Në Euro)
Motorike	42,394,471
Pasuria	5,051,805
Shëndeti & Aksidentet	17,226,769
Marina dhe Mall	62,859
Jeta	1,300,000
<b>Total</b>	<b>66,035,905 Euro</b>



**Maqedoni e Veriut:**

Publikimi i raportit të Agjensisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve për vitin 2021 në Maqedoninë e Veriut, ka përcaktuar rritjen e dëmeve të paguara me 13%, duke arritur shifrën e 11.5 milionë eurove. Qytetarët, kompanitë, shoqatat dhe institucionet shtetërore kanë arkëtuar mbi 4 miliardë denarë (66,2 milionë euro) nga shoqëritë e sigurimeve për dëmet e mbuluara nga sigurimet jo-jetë në vitin 2021.



Kompania e sigurime "UNIQA

AD" është renditur mes kompanive që kanë paguar më shumë për dëme në vitin 2021, me një shifër në total prej 6.6 milionë euro.

Sigurisht që rritja e kërkesës dhe besimit të qytetarëve maqedonas solli edhe nevojën për të qenë më pranë klientëve me zyra të reja në bulevardin Ilinden në kryeqytetin e Shkupit, të përshtatur në ambiente me kushte bashkëkohore dhe me një staf mjaft profesional. Inagurimi i zyrave të reja u bë nga Presidenti i Bordit mbikqyrës

të SIGAL UNIQA GROUP në Shqipëri, Maqedoni e Veriut dhe Kosovë Z.Avni Ponari së bashku me Ambasadorin e Republikës së Austrisë Dr. Georg Woutsas, Drejtorin e UNIQA Maqedoni Z. Driton Azizi si dhe Drejtoresha e UNIQA Life Znj. Aleksandra Shkëmbi Antovska.

Me një skuadër të madhe prej më shumë se 300 punonjësish, SIGAL Macedonia vijon rrugën drejt suksesit të padiskutueshëm në tregun e sigurimeve në vend.



Burimi AMS: Raporti Janar-Shtator 2021



**Driton Azizi**  
Drejtor i Përgjithshëm  
UNIQA Maqedoni e Veriut



"SIGAL AD" në Maqedoninë e Veriut filloi historinë e suksesit në Tetor 2004 duke hapur dyert e 14 degëve. Sot "UNIQA AD" është në dispozicion përmes 47 pikave të shitjes në të gjithë Maqedoninë e Veriut, ku i siguruari mund të lidhë një policë ose të raportojë dëm. Pikërisht qëndrimi i drejtë në vlerësimin e dëmeve dhe shërbimi në kohë janë shtysat për rritjen e besimit dhe nxitëse të rritjes së primit të shkruar bruto gjatë këtyre viteve, të cilat e vendosën "UNIQA AD" në pozitën udhëheqëse në segmentin e auto-përgjegjësive, klasa e cila sjell më shumë prime në tregun e sigurimeve në Maqedoninë e Veriut. Me hapjen e "pikës së shitjes" së 48-të, që është mundësimi i lëshimit të policave on-line, përmes faqes së internetit të shoqërisë, "UNIQA AD" ka treguar se fokusi nuk është vetëm tek klientët ekzistues, por edhe tek mijëvjeçarët, brezat që do të vijnë, të cilët thuhet se "kanë lindur me një celular në dorë". Dixhitalizimi i shitjeve është një proces i pashmangshëm në transformimin e një shoqërie tradicionale në një shoqëri sigurimi moderne. Liberalizimi i ardhshëm i tregut të auto-përgjegjësive do të sjellë rritje të konkurrencës, të cilën "UNIQA AD" me siguri do ta kapërcejë duke u ofruar klientëve jo vetëm besim, por edhe novacion.



Dëme të paguara (2004-2021)	Vlera (Në Euro)
Motorike	40,110,268
Pasurisë	12,894,358
Shëndeti & Aksidentet	5,525,851
Jeta	1,203,252
<b>Total</b>	<b>58,530,477 Euro</b>



**Aleksandra Shkëmbi Antovska**  
Drejtoresha e Përgjithshme  
UNIQA LIFE Maqedoni e Veriut

UNIQA LIFE u themelua në vitin 2011, kur filluam punën me një ekip prej vetëm katër punonjësish dhe një portofol me dy produkte për sigurimin e jetës. Sot, UNIQA LIFE është një nxitës në tregun maqedonas të sigurimeve të jetës duke e mbyllur vitin 2020 si një lider në numrin e kontratave të reja, gjë që tregon se ne kemi më shumë se 30,000 klientë të kënaqur që na kanë dhënë besimin e tyre. Ne jemi veçanërisht krenarë për faktin se sot portofoli ynë i sigurimeve përmban 8 produkte, të cilat janë përshtatur plotësisht me kërkesat dhe nevojat e klientëve tanë. Përvoja dhe mbështetja që UNIQA LIFE merr nga SIGAL UNIQA Group AUSTRIA dhe UNIQA Insurance Group, si dhe angazhimi dhe profesionalizmi i të gjithë punonjësve, është një garanci që ne do të formësojmë të ardhmen e industrisë së sigurimeve në Maqedoninë e Veriut dhe në të njëjtën kohë do të ndihmojmë klientët tanë të jetojnë një jetë më të sigurt, më të mirë dhe më të gjatë.



## Klinika Lëvizëse "SIGAL UNIQA", 5.849 vizita dhe 4,525 km të përshkruara prej 2015-ës

*Kemi bërë të mundur që të shkelim të gjithë territorin e Shqipërisë dhe t'i krijojmë mundësinë të gjithë qytetarëve, burra dhe gra, vajza dhe djem, që të kontrollohen dhe të kenë mundësinë për të parë veten e tyre", shprehet CEO i SIGAL UNIQA, z.Avni Ponari.*



Klinika Lëvizëse "SIGAL UNIQA" ka kryer konsulta dhe ekzaminime FALAS në shumë zona të ndryshme të vendit.

Me qëllim promovimin e shëndetit të mirë, SIGAL UNIQA ndërtoi të parën dhe të vetmen Klinikë Lëvizëse Shëndetësore në rajon, e cila që prej 2015-ës ka ofruar ekzaminime shëndetësore falas për qindra banorë në çdo cep të Shqipërisë, që nga Valbona, Thethi, Lëpusha, Bajram Curri, Shkodra, Lezha, Korça, Pogradeci, Elbasani, Tirana, Berati, Vlora, Saranda, Konispoli etj.

Prej vitit 2015 "Vital Truck" ka bërë rreth 4500 km, njësoj si ti biesh Shqipërisë katër herë rreth e qark.

"Më mirë është ta parandalosh një sëmundje se sa ta kurosh atë! Kjo na ka bërë që të ndërtojmë një strategji të gjithanshme dhe t'i shërbejmë klientëve në çdo pjesë të territorit brenda dhe jashtë Shqipërisë. Kemi krijuar këtë platformë, këtë klinikë të lëvizshme, e cila kryen vizita për 8-9

lloje të ndryshme sëmundjesh, duke përfshirë edhe imazheritë e ndryshme që janë të domosdoshme.

Mjekja e SIGAL, znj. Erjeta Ashiku shprehet: "VitalTruck" ofron një gamë të gjerë shërbimesh mjekësore. Në fund të vitit 2021 ne ishim në zonën e Shkodrës dhe Velipojës. Duke qenë se sapo kishim kaluar tetorin, muajin e sensibilizimit për Kancerin e Gjirit, një rëndësi e veçantë ju dha shëndetit të gruas me ekon e gjirit. Qindra gra u vizituan, kryen kontrollat e nevojshme mjekësore përmes aparaturave bashkëkohore dhe morën konsulta falas nga stafi ynë".

"VITAL TRUCK" do të vazhdojë udhëtimet e tij mjekësore edhe në të ardhmen në çdo zonë të Shqipërisë nga Jugu në Veri e nga Lindja në Perëndim.

Kjo nismë madhore e kompanisë sonë, unike në llojin e saj jo vetëm në Shqipëri, ka për synim sensibilizimin e qytetarëve mbi rëndësinë që ka shëndeti në përditshmërinë tonë. Për këtë arsye, në paketat tona të sigurimeve një pjesë të rëndësishme zënë ato shëndetësore duke sjellë edhe ide inovative për tregun siç është edhe Teleshëndet.

## Të humbur në tingujt magjik të Orkestrës së Harqeve SIGAL UNIQA...

Kultura dhe arti është civilizim, ecuri dhe zhvillim i një vendi që lufton të jetë përparimtar drejt asaj ç'ka synojmë gjithmonë, demokracinë. Ndaj dhe SIGAL Uniqa Group Austria nuk ka reshtur së mbështeturi ndër të tjera edhe kulturën, duke i kushtuar një hapësirë shumë të rëndësishme kësaj fushe në mesin e të gjitha projekteve madhore që zhvillohen çdo ditë në duart e një stafi profesionistësh. Por si?

Që prej vitit 2009 në SIGAL UNIQA është themeluar Klubi i Artit dhe Kulturës që i ka shërbyer artistëve të rinj dhe profesionistë të letërsisë, muzikës dhe atyre të arteve pamore që të zbulojnë më tepër rreth asaj që mund të ndryshojmë në Shqipëri falë të bukurës. Me dhjetëra aktivitete kulturore të zhvilluara, ekspozita pikturore, mbrëmje muzikore, portrete artistësh, promovime librash dhe seminare me tematika të ndryshme, Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA ka hapur një faqe të re në atë që më pak është vlerësuar në vendin tonë, artistin.

Nëpërmjet këtij novacioni dhe ideje brilante, sot Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA ka bashkuar të tre artet në një trup të vetëm duke mundësuar shpenzim cilësor të kohës suaj të lirë. Por përveç këtyre, Sigal Uniqa

Group Austria ka mbledhur 15 instrumentistë profesionistë në gjirin e saj, ku që prej vitit 2013 formojnë Orkestrën e Harqeve. Orkestra e Harqeve SIGAL UNIQA është e para dhe vetmja në rajon e kësaj forme, e drejtuar denjësisht nga Mjeshtri i Madh Ermir Dizdari.

Në muajin mars meloditë e veçanta të harqeve të 15 instrumentistëve profesionistë zbritën në Valbonën e egër dhe të bukur, bijën e brishtë të veriut të Shqipërisë, duke dhuruar një shfaqje të papërsëritshme me pjesë të përzgjedhura muzikore nga Prenk Jakova, Ylli Ramzoti, Česk Zadeja, si edhe nga Johann Sebastian Bach dhe Antonio Vivaldi.

Ajo ka marrë vlerësime të shumta, ku vlen të përmendet Çmimi i parë i Edicionit të Pestë të Takimit Kombëtar të Orkestrave të Harqeve dhe Muzikës së Dhomës si dhe Çmimin e rëndësishëm Ndërkombëtar "Xhoja".

SIGAL UNIQA Group Austria është e vendosur që do të mbështesë nismat artistike si mënyrë që për të ruajtur brez pas brezi trashëgiminë kulturore të vendit tonë.



**Orkestra e Harqeve e Klubit të Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA** që nga themelimi i saj në 2013 ka dhënë me dhjetëra shfaqje artistike në shumë qytete të Shqipërisë dhe është vlerësuar me çmime të rëndësishme për performancën e saj, ku mund të përmendim çmimin e parë të edicionit të pestë të Takimit Kombëtar të Orkestrave të Harqeve dhe Muzikës së Dhomës si dhe Çmimi Ndërkombëtar "Xhoja", një nga më të rëndësishmit në fushën e artit.





## SIGAL UNIQA, partnere e përhershme e Sportit

Sporti bashkon zemrat dhe promovon një jetë të shëndetshme. Si i tillë e kemi vlerësuar çdo vit, duke kontribuar pothuaj në të gjitha disiplinat sportive.

Prej vitesh mbështesim Federatën Shqiptare të Futbollit dhe atë të Basketbollit duke qenë sponsor zyrtar të saj;

Ringritëm klubin e basketbollit Valbona dhe e shpallëm kampione;

Prej më shumë se 15 vitesh mbështesim kampionen e basketbollit SIGAL Prishtinën, e cila edhe falë mbështetjes sonë është

shpallur 12 herë kampione e Superligës dhe ka fituar 2 kupa Ballkanike;

Liga Ballkanike e Basketbollit u riemërua SIGAL UNIQA Ballkan League falë bashkëpunimit disa-vjeçar me SIGAL UNIQA;

Kemi ndërtuar fusha basketbolli për të rinjtë në Tiranë dhe kemi kontribuar në zhvillimin e basketbollit në të gjithë vendin.

Kemi mbështetur alpinizmin për disa vite dhe alpinistë profesionistë;

Në atletikë talentët Izmir Smajlaj dhe Luiza Gega janë

mbështetur financiarisht nga SIGAL UNIQA;

Aeronautika shqiptare me aktivitetin “Albania Open”;

Motor Fest, Rally Albania; garat me motorë Vespa;

Regatën Lundrimore për fëmijët e fshtatit SOS;

Kampionatin e vollejbollit;

Kampionatin e parë ndërkombëtar të Shahut;

Kampionatin e Çiklizimit;

Konkursin e dancit sportiv;

Biçikletat për policinë

e patrullimit në plazhet shqiptare;

Ndërkohë kemi hedhur në treg një produkt unik sigurimi, i cili u vjen në ndihmë pikërisht botës së sportit, Sigurimi nga Aksidentet për Sportistët.

“Shëndeti është shumë i rëndësishëm për një sportist. Ndaj do ti sygjeroja çdo federate dhe ekipi në Shqipëri të sigurojnë lojtarët e tyre në mënyrë që karriera e një e futbollisti të mos mbetet në duart e fatit. Dëmtimi i futbollistit, përveç kostove shëndetësore individuale, kanë edhe kosto financiare për klubet apo federatat respektive”, do të shprehej

në një intervistë për Top News Kryetari i Shoqatës së Futbollistëve dhe ish futbollisti i Kombëtares, Andi Lila.

Por çfarë mbulon “SIGURIMI I SPORTISTËVE” nga SIGAL UNIQA?

Si sportistë profesionistë, por edhe nëse jeni sportistë amator, ju do të keni nevojë për sigurimin nga dëmtimet apo aksidentet që mund të ndodhin.

PAKETA E “SIGURIMIT PËR SPORTISTËT” NGA SIGAL UNIQA OFRON MBULIM PËR: Humbje jete në rast aksidenti sportiv

Paaftësi e përkohshme në rast aksidenti sportiv Paaftësi e përkohshme (Shpërblim ditor)

Shpenzime mjekësore në rast aksidenti sportiv

Përfitimet: Garanci financiare për sportistin për shpenzime mjekësore nga aksidenti Vlerë për punëdhënësin që siguron sportistët Garanci për ekipin që detyrimet që mund ti lindin i paguan siguroesi

Kujt mund ti ofrohet? Të gjitha Federatave Të gjitha ekipeve sportive Sportistëve në sporte individuale

## 2021 viti i suksesit të padiskutuar të UNIQA Insurance Group

Në një kohë kur menduam se viti 2021 do të ishte fundi i pandemisë SARS COV 2 dhe do të shënonte nisjen e rimëkëmbjes, një tjetër seri sfidash ekonomike goditën Evropën. Përveç luhatjeve të frikshme të shifrave të të infektuarve me Covid-19, rritjes së viktimave për shkak të virusit, mungesave të hapësirave mjekësore për të trajtuar pacientët, ekonominë evropiane nisi ta kërcënonte seriozisht edhe kriza energjitike dhe fatkeqësitë e njëpasnjëshme natyrore.

Përmbytjet, erërat e forta, reshjet e dendura të shiut, rrëshqitjet e dherave në pjesën më të madhe të Evropës, i gjetën Gjermaninë, Italinë, Francën, Holandën, Austrinë dhe shumë vende të tjera të papërgatitura. Vlera e dëmeve të vlerësuara arriti në shifra kolosale, ndërkohë që u shënuan më shumë se 220 viktimat si pasojë e shkatërrimit total të shumë fshatrave. Një situatë e tillë sigurisht që shkaktoi shumë probleme në ekonominë e brishtë të kontinentit të vjetër, që njëkohësisht vijonte luftën e madhe me një virus të padukshëm.

Padyshim që një tjetër goditje ishte edhe kriza energjitike, e cila është parashikuar që do të zgjasë

për një periudhë mjaft të gjatë. Një gjendje e tillë po ndikon edhe në faturat e konsumatorëve, ku deri më tani kostoja llogaritet deri në katër herë më e lartë se ajo e një vitit më parë.

Situata shpeshherë shikohet me një sy kritik, duke u cilësuar si mjaft delikate, por rimëkëmbja vjen gjithmonë nëse ka një menaxhim të mirë. UNIQA sa i përket këtyre problematikave ka mbajtur gjithmonë një qëndrim profesional, si dhe ka prezantuar idetë e saj novative në përmirësimin e situatës, duke iu bashkuar kështu edhe me arritjet e kompanisë përgjatë vitit të fundit.

UNIQA arriti të korre suksese të vazhdueshme në vitin që lam pas, duke arritur qëllimet e vendosura për një performancë të qëndrueshme biznesi, si dhe përbushjen e pritshmërive pozitive të integritit të suksesshëm të kompanisë të mëparshme AXA në rajonin e EQL. Pavarësisht goditjes së pjesës më të madhe të Evropës nga stuhi të vazhdueshme reshesh dhe erërash, që shkaktuan dëme të mëdha, viti i parë në të cilin u zbatua strategjia e korporatës UNIQA 3.0 shënoi një themel të fortë në objektivat ambicioze të UNIQA.

insipori shumë. Historitë që ju tregoni janë shumë frymëzuese. Ju felenderojmë që jeni pjesë e skuadrës së UNIQA.

Me UNIQA 3.0 ne jemi lider në një rrugëtim transformues për të ardhmen”, ka thënë CEO i UNIQA Insurance Group, Andreas Brandstetter.

Sukseset kanë qenë të njëpasnjëshme përgjatë vitit 2021. Gjigandi austriak i sigurimeve “UNIQA Insurance Group” tashmë është edhe anëtar i ‘Net Zero Asset Öener Alliance’, si e para kompani austriake që iu bashkua investitorëve global në sektorin bankar dhe të sigurimeve të iniciuar nga Kombet e Bashkuara. Falë punës intensive, UNIQA është vlerësuar nga studimi i Gallup/ForumF si lider novacioni në sektorin financiar, që do të thotë se gjigandi austriak i sigurimeve është deri tani më i besuari për të gjeneruar inovacione dhe gjithashtu për t’i ofruar ato.

UNIQA Insurance Group është grupi i 5-të më i madh i sigurimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore duke zotëruar 40 kompani në 18 vende, 15.5 milionë klientë dhe rreth 23,500 punonjës dhe partnerë ekskluzivë shitjesh.

Prej vitit 2007, pjesë e UNIQA Insurance Group është edhe SIGAL. Ky partneritet i shkëlqyer e rendit SIGAL UNIQA Group Austria, si kompaninë lider dhe më të suksesshme, më të madhe dhe më të besuar në sigurimet Jo Jetë dhe Jetë, i vlerësuar si i tillë nga rrjeti i klientëve dhe partnerëve të saj në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

### UNIQA GROUP

Zotëron rreth 87% të aksioneve të SIGAL

Mbi 200 vjet histori dhe përvojë në Europë

Zotëron 21% të tregut Austriak

18 shtete Europiane

40 kompani sigurimi

€ 7.8 mld prime të shkruara

€ 33 mld asete

25 mln kontrata

15.5 mln klientë

21.3 mijë punonjës

I pari investitor strategjik në tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon



## SË BASHKU NË ÇDO SFIDË

Vitet e fundit kanë qenë dinamike, me ngjarje të pazakonta për mbarë globin dhe me sfida për të gjithë. Një virus i rrezikshëm për jetën, i quajtur SARS COV 2 gjunjëzoi jo vetëm një vend të vogël si Shqipëria, por edhe qeveritë dhe ekonomitë më të mëdha botërore.

Kjo ishte një ngjarje përtej çdo imagjinate dhe kostoja në jetë njerëzish deri më tani arrin në miliona njerëz. Shifrat e humbjes ekonomike shkojnë me trilionat dollarë në gjithë globin, ndërsa humbjet vazhdojnë të thellohen nga dita në ditë.

Për Shqipërinë sëmundja e shekullit e quajtur ishte dërmuese, duke patur parasysh ekonominë e brishtë që kemi, dhe pa harruar këtu që vendi ynë vinte nga një goditje e fortë njerëzore dhe ekonomike për shkak të tërmeteve të fundvitit 2019.

Në ngjarje si këto që i kalojnë përmasat njerëzore askush nuk mund të bëjë heroin por ama gjithkush duhet të dijë të bëjë detyrën e tij.

Të përgjegjshëm për detyrimet kontraktuale dhe të ndjeshëm

për ngjarjet që prekën të gjithë komunitetin SIGAL UNIQA Group Austria tregoi edhe njëherë se ajo është jo vetëm kompania lider në sigurime, por është lider edhe kur bëhet fjalë për tu gjendur pranë jo vetëm klientëve të saj por gjithë komunitetit shqiptar brenda dhe jashtë kufijve.

Edhe tërmetet e vitit 2019 nxorën edhe një herë në pah forcën e SIGAL UNIQA-s.

Me dorën në zemër dhe dëshirën e mirë për të kontribuar sadopak për familjet shqiptare që u prekën nga tërmetet e fundvitit që lamë pas, SIGAL UNIQA dhuroi 60 mijë euro, një shumë sa simbolike por aq edhe domethënëse, që na tregon të gjithëve se duke kontribuar të gjithë nga pak, në fund bëhet shumë.

Menjëherë pas tërmeteve SIGAL UNIQA identifikoi të gjithë klientët e saj të prekur nga tërmetet dhe në një kohë rekord dëmshpërbleu dhjetëra familje dhe biznese me vlerë mbi 12 milionë euro.

Në shenjë solidarizimi për të gjithë shqiptarët e prekur nga COVID 19, por edhe si shenjë e mbështetjes dhe falënderimit për punën e jashtëzakonshme

të bluzave të bardha, SIGAL UNIQA dhuroi një aparat portativ radiologjik për Spitalin Shefqet Ndroqi Tiranë, duke vënë kështu një tullë të vogël në murin e madh që duhet ngritur për të luftuar këtë virus të tmerrshëm.

Për të ndihmuar dhe lehtësuar sa më shumë qytetarët të cilët kishin nevojë për këshilla mjekësore, por që ngurrnin të shkonin nëpër spitale për shkak të situatës nga COVID 19, në muajt mars-prill që përkonin me fillimet e pandemisë, SIGAL UNIQA vuri në dispozicion të çdo shqiptari, krejtësisht falas, platformën më të re të mjekësisë online TeleShëndet.

Duke instaluar falas aplikacionin me mijëra qytetarë u këshilluan online 24 orë për simptomat e COVID 19 por edhe për sëmundje të tjera me mjekët më të mirë specialistë të fushës.

Me dëshirën dhe besimin që do ti kalojmë së bashku dhe sa më shpejt këto sfida të mëdha, SIGAL UNIQA Group Austria mbetet partneri juaj për një jetë më të mirë dhe më të sigurtë përballë çdo sfide që mund të na sjellë e ardhmja...



Bordi Drejtues i SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

## Staf profesional dhe i motivuar, çelësi i suksesit në SIGAL UNIQA.



Departamenti i Pasurisë dhe Garancisë



Departamenti Legal, Compliance dhe Burimeve Njerëzore



Departamenti i Financës



Departamenti i Aktuaristikës





Departamenti i Shëndetit dhe Aksidenteve Personale



Departamenti i Mjeteve Motorike



Departamenti i Jetës



Fondi i Pensioneve



Departamenti i Marinës dhe Aviacionit



Departamenti IT



Departamenti i Dëmeve Motorike Shëndetësore



Departamenti i Dëmeve Motorike TPL Materiale



Departamenti i Regresit



Departamenti i Dëmeve Karton Jeshil dhe Fond Kompesimi



Departamenti i Dëmeve Motorike Kasko



Zyra e Administrimit



Departamenti i Marketingut



Departamenti i Kontrollit të Brendshëm



Zyra e Mjekëve



Klubi i Shëndetit



Dega Tiranë 1



Dega Tiranë 2



Dega Durrës 2



Dega Korçë



Dega Tiranë 3



Dega Tiranë 4



Dega Elbasan 1



Dega Elbasan 2



Dega Tiranë 5



Dega Tirane 6



Dega Fier 1



Dega Fier 2



Dega Tiranë 7



Dega Durrës 1



Dega Vlorë



Dega Lushnje



Dega Shkodër 1



Dega Shkodër 2



Dega Berat



Dega Sarandë



Dega Pogradec



Dega Lezhë



SIGAL UNIQA Group Austria Kosovë



Dega Gjirokastrë 1



Dega Gjirokastrë 2



Dega Kukës



Dega Dibër



UNIQA Maqedoni e Veriut



**SIGAL UNIQA Group AUSTRIA**  
Albania

**Drejtoria e Përgjithshme / Headquarter**  
Blv. "Zogu I", Nr. 1, Tirana - Albania  
Tel. (+355) 4 2233 308, Fax. (+355) 4 2250 220,  
e-mail: info@sigal.com.al, www.sigal.com.al

#### Tiranë 1

Blv. "Zogu I", pll. Diplomatëve, nr. 57  
Tel. (+355) 2233 308

#### Tiranë 2

Rr. Donika Kastrioti, pas Kullave Binjake  
Tel. (+355) 44 511 666

#### Tiranë 3

Blv. Gejrgj Fishta, Komplekti Delijorgji  
Tel. (+355) 44 330 171

#### Tiranë 4

Rr. Elbasanit, përballë ish- 7xhuxhat  
Tel. (355) 68 40 81979

#### Berat

L. "28 nëntori"  
Tel. (+355) 32 234605

#### Dibër

L. "Nazmi Rushiti", Peshkopi  
Tel. (+355) 218 25155

#### Durrës 1

L. nr. 3, rr. "Skënderbej",  
qendra e Biznesit Monun  
Tel. (+355) 522 31047

#### Durrës 2

Rruga Tregtare, Nr.42, Blv. Kryesor  
Tel. (+355) 69 365 7105

#### Elbasan 1

L. "28 Nëntori", Rr. "11 Nëntori",  
pll.109/1, Kati 2  
Tel. (+355) 54 244446

#### Elbasan 2

L. "Kongresi Elbasanit", Rr. "Baki  
Kongoli", shatërvani kryesor  
Tel: (+355) 69 40 96 303

#### Fier 1

L. "1 Maji", Rr. Jani Bakalli,  
tek Kupola Center  
Tel. (+355) 69 209 3814

#### Fier 2

L. "Apollonia", blv. "Jakov Xoxa",  
pll. 1, shk. 4  
Tel. (+355) 342 23035

#### Fushë Krujë

Pallati hark, qendër  
Tel. (+355) 563 22869

#### Gjirokastrë 1

L. "Punëtore", Rr. "Nacionale"  
Tel. (+355) 842 67080

#### Kavajë

L. nr. 1, Sallbeg  
Tel. (+355) 552 42562

#### Korçë

Blv. "Republika", pranë  
Kinema Milenium  
Tel. (+355) 822 50433

#### Kukës

L. nr. 5  
Te. (+355) 242 24532

#### Laç

Qendër  
Tel. (+355) 536 4578

#### Lezhë

L. Besëlidhja, sheshi Besëlidhja  
Tel. 0215 24656

#### Lushnje

L. "Loni Dhamo"  
Tel. (+355) 352 21532

#### Mamurras

Qendër  
Tel. (+355) 69 20 25 829

#### Mat

L. "Partizani", Burrel  
Tel. (+355) 217 22746

#### Përmet

Shëtitorja "Odhise Paskali"  
Tel. (+355) 813 23293

#### Pogradec

L. Nr 2 Rr., "Rinia", pallati 80  
Tel. (+355) 832 26792

#### Pukë

Rr. "Imer Puka", blloku nr. 1  
Tel. (+355) 212 22880

#### Rrëshen

Sheshi "Abat Doçi", Mirditë  
Tel. (+355) 69 20 74 581

#### Sarandë

L. nr. 1, rr. "Flamurit", nr. 19  
Tel. (+355) 852 25045

#### Shkodër 1

L. "Vojo Kushi", Rr. "Çlirim",  
pranë teatrit "Migjeni", Kati II  
Tel (+355) 222 44429

#### Shkodër 2

L. "V.Shanto", Rr. "Çajupi", pll.  
Fishta 2  
Tel. (+355) 222 49680

#### Tropojë

Qendër, Bajram Curri  
Tel. (+355) 213 23101

#### Vlorë

L. Pavarësia, Qendra Tregtare  
Riviera  
Tel. (+355) 332 23121



**SIGAL UNIQA**  
Group AUSTRIA  
Kosova

**Drejtoria / Head Office**  
Rr. "Ukshin Hoti", Pejton, 10,000, Prishtinë – Kosovë,  
Tel. (+383) 38 240 241, E-mail: info@sigal-ks.com,  
www.sigal-ks.com

#### Prishtinë

Rr. "Dëshmorët e Kombit",  
nr. 72/a, Lagja Ulpian  
Tel. (+381) 38 550 576

#### Ferizaj

Rr. "William Wolker" p.n  
Tel. (+381) 290 320 536

#### Gjakovë

Rr. "E Tiranës" p.n  
Tel. (+381) 44 188 354

#### Gjilan

Rr. "Adem Jashari"  
Tel. (+381) 280 320 810

#### Mitrovicë

Rr. "Adem Jashari" p.n  
Tel. (+381) 44 263 742

#### Pejë

Rr. "Mbretresha Teutë" p.n  
Tel. (+381) 39 420 092

#### Prizren

Rr. "William Woker" p.n  
Tel. (+381) 29 244 024

**UNIQA**  
Maqedoni e Veriut

**Drejtoria / Head Office**  
Blv. "Ilinden", Nr.1, Shkup, Maqedoni  
Tel. (+389) 2 3109 060, Fax. (+389) 2 3215 128,  
E-mail: info@uniqa.mk, www.uniqa.mk

#### Shkup

Xhon Kenedi, nr. 27  
Tel. (+389) 2 2621 211

#### Berovë

Marshal Tito nr. 115  
Tel. (+389) 75 811 801

#### Delcevo

Nikola J. Vapcarov  
Tel. (+389) 75 309 005

#### Dibër

Bratstvo Edinstvo  
Tel. (+389) 46 835 145

#### D. Hisar

Goce Delcev Nr.9A  
Tel. (+389) 47 275 000

#### Gostivar

Dimitar Vlaho  
Tel. (+389) 42 221 046

#### Gjevgjeli

7 Noemvri  
Tel. (+389) 34 218 568

#### Kavadar

Ilidenska nr. 115  
Tel. (+389) 34 400 288

#### Kërcovë

Kuzman Jusfovski Pitu  
Tel. (+389) 45 224 290

#### Koçan

Marshal Tito 86 A  
Tel. (+389) 33 272 150

#### Kriva Palanka

Marsal Tito nr.230a  
Tel. (+389) 31 372 182

#### Kumanovë

Potok Serava nr. 2  
Tel. (+389) 31 437 187

#### Manastir

Stalarska  
Tel. (+389) 47 203 646

#### Negotivë

Marshal Tito nr. 43  
Tel. (+389) 43 370 590

#### Ohër

Bul. Turisticka bb zgr.  
Remis Kifla  
Tel. (+389) 46 231 616

#### Prespë

Leninova  
Tel. (+389) 47 453 000

#### Prilep

11 Oktomvri Lam.A 8  
Tel. (+389) 48 427 657

#### Probishtip

Hristjan T. Karposh  
Tel. (+389) 32 480 860

#### Radovish

Marsal Tito nr.23  
Tel. (+389) 32 630 309

#### Strugë

JNA  
Tel. (+389) 46 783 201

#### Strumicë

Mladinska Nr. 45  
Tel. (+389) 34 430 083

#### Shën Nikollë

Ilined  
Tel. (+389) 32 444 045

#### Shtip

Tosho Arsov nr. 38  
Tel. (+389) 32 389 710

#### Tetovë

Ilindenska, nr. 51  
Tel. (+389) 44 351 630

#### Veles

Strasho Pinxhur nr. 6  
Tel. (+389) 32 43 211 806

#### Vinice

Ilidenska  
Tel. (+389) 33 364 559



E ardhmja që na frymëzon.

# InsurTech

Konkurs për zbulimin e talenteve të reja në botën dixhitale.

Jepini vetes një mundësi për të fituar çmimin e madh

**1,500 euro**

**Aplikoni online**  
22 shkurt - 15 mars 2022

